



M A N U A L

# E DREJTA PËR ARSIM

Përgatiti: **Elvin Gjevori, PhD**  
**Ina Xhepa, MSc.**

ISBN:

Ky manual u përgatit nga Fondacioni Qendra Europiane me mbështetjen e Fondacionit Konrad Adenauer Programi i Shtetit të së Drejtës për Evropën Juglindore në kuadër të projektit “E drejta për arsim”.

Përmbajtja e këtij materiali është përgjegjësi e vetme e Fondacionit Qendra Europiane dhe jo domosdoshmërisht paraqet pikëpamjet e Fondacionit Konrad Adenauer.

© Të gjitha të drejtat e rezervuara. Asnjë pjesë e këtij botimi, mbrojtur nga ligji nr. 35/2016 “Për të drejtat e autorit dhe të drejta të tjera të lidhura me to”, nuk mund të riprodhohet, ruhet, transmetohet a përdoret me asnjë formë e mjet grafik, elektronik apo mekanik, përfshirë por jo kufizuar fotokopje, skanime, digjitalizim, rrjet ueb apo sisteme të tjera pa lejen me shkrim të botuesve.

Për informacione ose komente mund të drejtoheni tek:

**FONDACIONI  
QENDRA EUROPIANE**

Rr. Vaso Pasha  
P. 20, Ap. 57  
Tiranë, Shqipëri  
Tel: + 355 4 451 9076  
[www.euro-centre.eu](http://www.euro-centre.eu)

**KONRAD-ADENAUER-STIFTUNG E. V.  
FOUNDATION OFFICE ALBANIA**

Blv. “Dëshmorët e Kombit”,  
Twin Tower 1, 11th Floor, Office A3  
Tirana, Albania  
Tel.: +355 4 22 66 525  
E-mail: [info.tirana@kas.de](mailto:info.tirana@kas.de)

M A N U A L

# E DREJTA PËR ARSIM

Elvin Gjevori, PhD Ina Xhepa, MSc.



Tiranë, 2020



# TABELA E PËRMBAJTJES

Parathënie.....	7
Metodologjia.....	9
Shkurtime.....	11

## **KREU I - E DREJTA PËR ARSIM NË SHQIPËRI..... 6**

1.1 Vështrim historik i të drejtës për arsim .....	13
1.1.1 Përpjekja për arsim në gjuhën amtare në Mesjetë .....	13
1.1.2 Arsimi në Shqipëri në periudhën e shpalljes së pavarësisë deri në përfundimin e luftërave botërore .....	14
1.1.3 Arsimi në Shqipëri (1945 - 1990).....	16
1.2 E drejta për arsim si e drejtë kushtetuese .....	19
1.3 Historik i shkurtër mbi rregullimin e të drejtës për arsim gjatë viteve 1990-2012 .....	21
1.4.1 Kuadri ligjor në fuqi mbi Sistemin Parauniversitar të Zakonshëm .....	24
1.4.2 Kuadri ligjor në fuqi mbi Arsimin dhe Formimin Profesional .....	34
1.5 E drejta për Arsim të Lartë .....	44
1.5.1 Depolitizim apo Dekomunistizim?.....	49
1.5.2 Konsolidim dhe autonomi e mëtejshme .....	51
1.5.3 Liberalizim dhe zgjerim i arsimit të lartë.....	52
1.5.4 Konsolidim dhe 'shtrëngim'.....	53
1.5.5 Përfundime paraprake - Shumë përparime dhe shumë punë për të bërë.....	56

## **KREU II - E DREJTA PËR ARSIM SI E DREJTË THEMELORE NË TË DREJTËN NDËRKOMBËTARE..... 31**

2.1 Akte Ndërkombëtare të miratuara nga Organizata e Kombeve të Bashkuara.....	60
2.2. Aktet Ndërkombëtare me Karakter Rajonal - Këshilli i Evropës .....	67
2.1.1. Konventa Evropiane për të Drejtat e Njeriut .....	68
2.1.2. Karta Sociale Evropiane dhe instrumente të tjera të KiE.....	70
2.3 Jurisprudenca e Gjykatës së Strasburgut në lidhje me të drejtën për arsimim .....	71
Fjalorth.....	87
Bibliografia.....	91





## PARATHËNIE

Të dashur lexues,

Manuali “E drejta për arsimim”, që po ju paraqesim është produkt i realizimit të fazës së parë të projektit me të njëjtin emër zbatuar nga Qendra Europiane dhe Fondacioni Konrad Adenauer (KAS) Shqipëri.

Misioni i Qendrës Europiane është të kontribuojë në konsolidimin e shtetit të së drejtës në Shqipëri, duke pasur një fokus të veçantë në zbatimin e standardeve të të drejtave të njeriut në nivel vendas.

KAS synon të zvogëlojë dallimet midis standardeve evropiane të së drejtës dhe demokracisë nga njëra anë dhe gjendjes aktuale të Shqipërisë nga ana tjetër. KAS ka ofruar në mënyrë të vazhdueshme mbështetje për Qendrën Europiane duke mundësuar konkretizimin e një sërë idesh në fushën e njohjes dhe promovimit të të drejtave të njeriut në Shqipëri, në kuadër të integritimit evropian të vendit.

Faza e dytë e projektit do të konkretizohet me veprimtari praktike në bashkëpunim me institucione të arsimit të lartë në vend, ku përpos fuqizimit të kapaciteteve përmes takimeve në terren do të përgatiten dhe dy leksione në formën e videove interaktive për t'u paraqitur në platformën e mësimit online [www.tedrejtatemia.al](http://www.tedrejtatemia.al)

Qendra Europiane dhe KAS, përmes këtij botimi synojnë të arrijnë një numër sa më të lartë përdoruesish në radhët e profesionistëve, punonjësve të administratës publike qendrore dhe vendore, studentëve të së drejtës dhe shkencave shoqërore, si edhe qytetarëve. Ky manual iu drejtohet të gjithë atyre lexuesve, që synojnë të marrin një informacion sa më të përditësuar për të drejtën për arsimim në nivelin parauniversitar dhe universitar. Këto realitete nuk mund të kuptohen të plota pa iu referuar zhvillimeve normative dhe praktikës në kuadër të mekanizmave kombëtare dhe ndërkombëtare në mbrojtje të të drejtave dhe lirive themelore të njeriut.

Ky publikim nuk do të ishte bërë i mundur pa kontributin e çmuar të dy kolegëve të Qendrës Europiane, znj. Sindi Lica dhe z. Arlind Maloku, të cilët asistuan ekspertët në detyra kërkimore.

Rezultati final i këtij projekti synon të përmirësojë njohuritë dhe kapacitetet e një serie përdoruesish në lidhje me një të drejtë e cila është thelbësore për fuqizimin e individit me qëllim kërkimin dhe realizimin e të drejtave të tjera të njeriut.

**Ina Xhepa, MSc.**  
Drejtoresh e Qendrës  
Europiane

**Dr. Tobias Ruttershoff**  
Shef i zyrës së KAS  
Shqipëri





## METODOLOGJIA

Përsa i takon metodologjisë, hartimi i këtij Manuali u realizua përmes hulumtimit dhe identifikimit, të materialeve përkatëse burimore, akteve normative kombëtare dhe ndërkombëtare në fushën e të drejtave të njeriut, duke u fokusuar në thelbin e temës së Manualit. Duke pasur në vëmendje një grup të gjerë lexuesish, jemi përpjekur të thjeshtojmë parashikime abstrakte, teori të mirë zhvilluara e të pasuruara të së drejtës për arsimim, që reflektohen në praktikë.

Pjesë e materialit teorik të mbledhur është edhe praktika e Avokatit të Popullit dhe Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi mbi tematikën e manualit, si dhe vendimmarrja e organeve shtetërore të krijuara posaçërisht për zbatimin e legjislacionit rregullues në fushën e arsimit, për të vijuar me mbledhjen dhe përzgjedhjen e jurisprudencës së GjEDNJ-së.

Manuali ka kufizimin e vet nga aspekti metodologjik. Ekzistenca dhe ushtrimi i të drejtave dhe lirive të njeriut është i vështirë të ndahet në grupime “të rëndësishme” apo “më pak të rëndësishme”. Gëzimi apo ushtrimi i një të drejte lidhet me liri apo të drejta të tjera, por fokusi i këtij manuali nuk është bërja e një panoramë të plotë apo shteruese të lirive dhe të drejtave

të njeriut, ndaj përmbajtja paraqitet e thjeshtuar, duke synuar qartësimin e zhvillimeve aktuale në Shqipëri rreth legjisla-  
cionit dhe institucioneve përkatëse, që garantojnë të drejtën  
për t'u arsimuar në Republikën e Shqipërisë.



## SHKURTIME

<b>AP</b>	Avokati i Popullit
<b>ASH</b>	Akademia e Shkencave
<b>BA</b>	Bachelor
<b>DUDNj</b>	Deklarata Universale e të Drejtave të Njeriut e OKB
<b>ECTS</b>	European Credit Transfer System
<b>GjEDNj</b>	Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut
<b>IAL</b>	Institucion i arsimit të lartë Institucione të arsimit të lartë janë: universitetet, shkollat
<b>ILP</b>	Institut i Lartë Pedagogjik
<b>KEDNj</b>	Konventa Evropiane për të Drejtat e Njeriut
<b>KiE</b>	Këshilli i Evropës
<b>KMD</b>	Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi
<b>MASH/ MASR</b>	Ministria e Arsimit dhe Shkencës / Sportit dhe Rinisë
<b>ME</b>	Master Ekzekutiv
<b>MP</b>	Master Profesional
<b>MPAL</b>	Ministria përgjegjëse për arsimin e lartë
<b>MSH</b>	Master Shkencor
<b>OKB</b>	Organizata e Kombeve të Bashkuara
<b>LAL</b>	Ligji i Arsimit të Lartë





# E DREJTA PËR ARSIM NË SHQIPËRI

## 1.1 Vështrim historik i të drejtës për arsim

### 1.1.1 Përpjekja për arsim në gjuhën amtare në Mesjetë

Historiku i zhvillimit të shkollave dhe arsimit shqip nga mesjeta e deri në ditët tona ka qenë në vijimësi një problematikë. Në vitet e pushtimit osman mësimi i gjuhës shqipe bëhej fshehurazi në ato pak shkolla fetare që u lejuan të vazhdonin veprimtarinë e tyre, si në vitin 1584, në Stubëll të Kosovës, në Himarë (1627), Kurbin të Krujës (1632), Vuno e Palasë të Himarës (1632), Korçë (1637), Pllanë (1639), Bilisht (1639), Dhërmi (1660), Janjevë (Kosovë) (1665), në Akademinë e Re në Voskopojë e në Medresenë e Bushatllinjëve në Shkodër, etj<sup>1</sup>.

Në periudhën e Rilindjes Kombëtare Shqiptare çështja e arsimit dhe shkollës shqipe u vu në qendër të vëmendjes. Për nevojat e shkollave shqipe u botuan një varg abetaresh si ajo e Naum Veqilharxhit (1844-1845), e Konstandin Kristoforidhit (1867-1868), e Daut Boriçit (1869), “Allfabetarja e Stambollit”

<sup>1</sup> Koliqi, H. (2002). *Historia e arsimit dhe e mendimit pedagogjik shqiptar*. Prishtinë: Universiteti i Prishtinës & Libri shkollor, f. 12.

(1879) etj. Një kontribut të rëndësishëm zhvillimit të arsimit dhe të shkollës shqipe i dha edhe “Shoqëria e të Shtypurit Shkronja Shqip” e Stambollit në krye me Sami Frashërin<sup>2</sup>. Në historinë e zhvillimit të shkollave shqipe dhe të arsimit kombëtar si pikënisje merret mësonjëtorja e Korçës, që nisi punë më 7 mars 1887,<sup>3</sup>të cilin e pason shkolla e Prizrenit në vitin 1889. Figurat më të shquara të kohës që dhanë kontribut në zhvillimin e shkollës shqipe ishin: Naum Veqilharxhi, Konstandin Kristoforidhi, Zef Jubani, De Rada, Thimi Mitko, Naim e Sami Frashëri, Pashko Vasa, Qiriazët etj. Me gjithë zhvillimin modest që mori arsimi në periudhën e rilindjes frekuentimi dhe ushtrimi i kësaj të drejte ishte tepër i ulët dhe i pabarabartë, kjo ndër të tjera dhe për një sërë arsyesh ekonomike e sociale.

### 1.1.2 Arsimi në Shqipëri në periudhën e shpalljes së pavarësisë deri në përfundimin e luftërave botërore.

Pas shpalljes së pavarësisë, arsimi ashtu sikurse pjesa më e madhe e sektorëve shtetëror, gjendej në një stad problematik, ku duhet të siguroheshin kushtet më minimale për të luftuar analfabetizmin<sup>45</sup>. Së bashku me aparatën qeveritare u krijua edhe Ministria e Arsimit ku ministër u vendos Luigj Gurakuqi. Gjuha shqipe u bë gjuhë zyrtare dhe nisi të ngrihej rrjeti shkollor në të gjithë vendin, ku krahas shkollave publike shtetërore u hapën dhe shkolla të huaja<sup>6</sup>. Pavarësisht këtyre përpjekjeve, nisja e Luftës së Parë Botërore e përkeqësoi situatën dhe nuk lejoi krijimin e një sistemi arsimor kombëtar

<sup>2</sup> Akademia e Shkencave e Shqipërisë. (2008). *Fjalor enciklopedik shqiptar (Vëllimi I)*. Tiranë: AKSH, f. 116-117.

<sup>3</sup> <https://shkolla1.weebly.com/historiku-i-shkolles.html> (konsultuar më 20.09.2020)

<sup>4</sup> Miço, H. (2019). *Një vështrim i përgjithshëm mbi të drejtën për arsim në Shqipëri ecuria e kësaj të drejte në përputhje me standardet ndërkombëtare dhe legjisllacionin evropian (punim doktrate)*, f. 8.

<sup>5</sup> Shema, I. (2019). *Periodizimi i zhvillimit të arsimit shqiptar gjatë shekujve*, <http://www.fokusi.org/periodizimi-i-zhvillimit-te-arsimit-shqiptar-gjate-shekujve/>

<sup>6</sup> ISP. (1990). *Historia e arsimit shqiptar: maket*. Tiranë, f. 271.

dhe gjithëpërfshirës<sup>7</sup>. E drejta për arsim gjatë kësaj kohe nuk u zbatua në praktikë.

Në periudhën 1920-24 u zhvilluan tre kongrese arsimore: në Lushnjë (1920, 1922) dhe në Tiranë (1924) dhe nisën përpjekjet për njësimin e shkollave shqipe, kombëtarizimin dhe laicizimin e tyre. Megjithatë, konsolidimi i sistemit arsimor nisi në periudhën 1925-1939, ku u rrit numri i shkollave në rang republike dhe u strukturua arsimi i mesëm në të përgjithshëm dhe profesional.

Dy ishin ligjet më të rëndësishme të miratuara gjatë qeverisjes së Ahmet Zogut:

1. Ligji organik i arsimit 1928; dhe
2. Dekret ligja organike 1934.

Të dy këto ligje synuan të reformonin sistemin arsimor shqiptar, i cili sikurse u përmend dhe më lart gjendej në stade mjaft problematike, veçanërisht pas ndikimit që Lufta e Parë Botërore pati për qeverinë e sapo formuar të Vlorës e më pas Principatën e Vidit.

Për herë të parë e drejta për arsim u përfshi si e drejtë themelore në Statutin Themeltar të Mbretërisë Shqiptare në 1928.<sup>8</sup> Ligji organik i arsimit 1928 synoi të krijonte një sistem ku shkolla fillore të ishte masive, e detyrueshme dhe falas. Ky ligj parashikoi për herë të parë arsimin si të drejtë-detyrë për qytetarët shqiptar si meshkuj dhe femra. Pavarësisht parashikimeve ligjore, jo të gjithë e gëzonin faktikisht të drejtën për të ndjekur shkollën. Familjet duhet të kontribuonin në buxhetin e shtetit për arsimin, shtetasit nuk konsideroheshin të gjithë të

<sup>7</sup> Miço, H. (2019). *Cituar më lart*, f.9.

<sup>8</sup> Anastas, A. (2007). *Historia e së drejtës kushtetuese në Shqipëri*. Tiranë: Pegi, f. 87-88.

barabartë dhe akses i veçanërisht për ata që jetonin në fshatra ishte i vështirë. Pra, autoritetet shtetërore nuk morën masat e nevojshme për ta realizuar në praktikë këtë të drejtë detyrë<sup>9</sup>.

Ndërkohë, dekret ligjja organike e 1934 ishte jetësimi i reformës arsimore të 1933, përmes së cilës u detyruan të mbylleshin të gjitha shkollat private në vend. Kjo vendimmarrje nuk u prit aspak mirë veçanërisht nga institucionet fetare. Shkollat private u rihapën në 1936<sup>10</sup>.

Pas nisjes së Luftës së Dytë Botërore, shkollat shqiptare u vendosën nën ndikimin italian. Përfundimi i luftës dhe vendosja e vendit në regjimin komunist solli një ndikim dhe reformim të sistemit arsimor sipas ideologjisë së kohës. Më tej do ndalemi të shpjegojmë zhvillimet e sistemit arsimor dhe të drejtës për arsim gjatë periudhës 1945-1990.

### 1.1.3 Arsimi në Shqipëri (1945 - 1990)

Me vendosjen e regjimit komunist në Shqipëri sistemi arsimor dhe e drejta për arsim morën një formë të re. E drejta e edukimit u parashikua në Kushtetutën e 1946<sup>11</sup> dhe në atë të 1976, me ndryshimin, që kjo e fundit shprehte qartë drejtimin ideologjik që duhet të ndiqte arsimi.

Tashmë shkolla ishte e tipit socialist dhe mbronte e brumoste një shoqëri të tillë. Sipas regjistrimit të 30 shtatorit 1945, në një popullsi prej 1.122.044 banorë, numri i analfabetëve ishte 911.410 banorë, ose 81.22% e popullsisë. Hapi i parë në luftën kundër analfabetizmit ishin kurset, të konsideruara të natës, të cilat njohën një përhapje të gjerë në të gjithë ven-

<sup>9</sup> Miço, H. (2019). *Cituar më lart*, f. 10-13.

<sup>10</sup> Ibid.

<sup>11</sup> Statuti i Republikës Popullore të Shqipërisë 1946 neni 28 dhe Kushtetuta e Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë, 28.12.1976, nenet 32, 33 dhe 57.



din nga 1945 në 1949. Për këtë fushatë kundër analfabetizmit u punua kryesisht në rrugë vullnetare. Në vitin 1955 u shpall publikisht se në Shqipëri ishte likuiduar analfabetizmi deri në moshën 40-vjeç, por në bazë të të dhënave arkivore faktohet se një pjesë e popullsisë nuk arriti të mësonte shkrim e këndim, sidomos moshat e mëdha.

Në lidhje me arsimin formal gjatë periudhës së regjimit komunist mund të theksojmë se pati 2 reforma kryesore: e para në 1946 dhe e dyta në 1963.

Ligji i 1946 për arsimin fillor të detyruar e organizoi sistemin arsimor si vijon:

- a. arsim fillor - 4 vjeçar;
- b. arsim unik - 7 vjeçar;
- c. arsim i mesëm - 4 vjeçar.

Ndërkohë arsimi i mesëm u nda në të përgjithshëm dhe profesional. Përpjekjet për të masivizuar ndjekjen e arsimit nga të gjithë u përforcuan dhe me miratimin e ligjit “Mbi arsimin 7 vjeçar të detyruar në 1952<sup>12</sup>. Shkollat pa shkëputje nga puna, ose të ashtuquajturat shkollat e natës nisën të reduktoheshin në 1953.<sup>13</sup>

Me reformën e parë në arsim, qeveria e kohës ndaloi ushtrimin e aktivitetit dhe për të gjitha shkollat private që funksiononin në Shqipëri, si liceu francez, shkolla italiane etj. Megjithatë, deri përpara viteve ’60 zhvillim dhe popullaritet më të madh patën shkollat 7-vjeçare. Përmirësim i cilësisë dhe rritje e numrit të shkollave të mesme u vërejt në vitet 1960. Në këtë periudhë u ndërmor dhe reforma e dytë e sistemit arsimor,

---

<sup>12</sup> Dekreti i Presidiumit të Kuvendit Popullor, nr. 1484, datë 12 qershor 1952, “Mbi arsimin shtatëvjeçar të detyruar”, Gazeta Zyrtare nr. 11, viti 1952.

<sup>13</sup> Vendim nr. 341, datë 03.11.1953. Mbi reduktimin e programeve të shkollave të natës.- Gazeta Zyrtare Nr.17, 14 nëndor 1953, f.401

e cila u jetësua me dy ligje të rëndësishme: ligji “Mbi riorganizimin e sistemit arsimor në Republikën Popullore Shqiptare” dhe ligji “Mbi arsimin 8 vjeçar të detyruar”. Fokusi edhe i reformës së dytë ishte intensifikimi i masave ndaj luftës kundër analfabetizimit. Kjo u vërejt edhe nga parashikimi i të drejtës së të gjithë shtetasve të ndiqnin shkollim në çdo nivel me ose pa shkëputje nga puna. Prioritet iu dha edukimit të klasës punëtore, duke jetësuar kështu dhe vijën ideologjike mbi të cilën bazohej reforma, atë marksist-leniniste.

Ideologjizimi i sistemit arsimor arriti kulmin me reformën e tretë në 1969, që u quajt “*revolucionarizimi i mëtejshëm i shkollës*”, e ndikuar nga revolucioni kulturor kinez.<sup>14</sup> Kurrikula e arsimit u hartua mbi bazën e një parimi, që u quajt trekëndëshi revolucionar dhe ishte: mësim, punë prodhuese dhe edukim fizik e ushtarak. Ky ideologjizim, parashikuar shprehimisht në ligj<sup>15</sup>, dëmtoi procesin mësimor dhe vazhdoi të thellonte politizimin e shkollës.

Pra, karakteristikat kryesore e të drejtës për edukim gjatë periudhës së regjimit komunist ishin:

- Arsimit i detyrueshëm dhe falas;
- Mungesë diversiteti zgjedhjeje në ofrimin/ushtrimin e kësaj të drejte;
- Sistem arsimor jo demokratik dhe laik;
- Akses *de facto* jo i barabartë për të gjithë.

Është me vend të theksohet se gjatë kësaj periudhe u ndër morën hapa për garantimin e të drejtës për tu arsimuar duke e konsideruar atë një të drejtë detyrë, por këto përpjekje në ligj dhe praktikë ndiqnin parime jo demokratike, duke mos i lënë shtetasve mundësi zgjedhjeje.

<sup>14</sup> Rrustaj, S. (2020). *Ideologjizmi në Shqipëri në vitet 1945-1990*.

<sup>15</sup> Ligji nr. 4624, datë 24.12.1969 “Mbi sistemin e ri arsimor”, neni 1.

## 1.2 E drejta për arsim si e drejtë kushtetuese

E drejta është një synim, kërkesë, nevojë ligjore, morale apo shoqërore, e cila u njihet qytetarëve nga organet qeverisëse<sup>16</sup>. Ndërsa, liria është e drejta për të vijuar jetesën individuale pa ndërhyrje nga ana e organeve qeverisëse. Liria nuk ka nevojë për mbikëqyrje me qëllim që individi ta gëzojë, mjafton që autoritetet të mos ndërhyjnë<sup>17</sup>. Kryesisht në kategorinë e të drejtave themelore në nivel ndërkombëtar përfshihen të drejtat civile dhe politike<sup>18</sup>. Ndërkohë, e drejta për arsim përfshihet në kategorinë e të drejtave dhe lirive ekonomike, sociale dhe kulturore. Të njëjtin qëndrim ka mbajtur edhe Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë, e cila e ka përfshirë atë<sup>19</sup> si të drejtë kushtetuese në kreun e lirive dhe të drejtave ekonomike e social-kulturore.

E drejta kushtetuese për t'u arsimuar shihet si e drejtë detyrë, ku në njërën anë të gjithë gëzojnë mundësinë për t'u arsimuar, e në anën tjetër parashikohen disa detyrime për ta jetësuar këtë të drejtë, detyrime të cilat bien mbi shtetin, prindërit por dhe vetë fëmijët. Prindërve kanë detyrim për të regjistruar fëmijët e tyre në shkollë, për të ndjekur të paktën ciklin e detyrueshëm me ligj<sup>20</sup>. Ndërsa mekanizmit shtetëror i lind detyrimi të sigurojë infrastrukturën e nevojshme falas për të bërë të mundur ushtrimin e të drejtës për arsim. Kohëzgjatja e arsimimit të detyrueshëm, parashikohet me ligj të veçantë dhe ky cikël ofrohet falas në institucionet arsimore publike. Krahas tij edhe arsimi i mesëm i përgjithshëm ofrohet falas<sup>21</sup>.

<sup>16</sup> Petrela, I. & Kodra, K. (2017). E drejta për informim dhe liria e shprehjes: manual. Tiranë: Qendra Europiane & KAS, f. 1.

<sup>17</sup> Ibid, f. 2.

<sup>18</sup> Mole, N. & Liaki, V. (2018). Drejt një zbatim të efektiv në nivel kombëtar të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut: një guidë mbi parimet konceptet kyçe të Konventës dhe përdorimi i tyre nga gjykatat vendase. Beograd: AIRE Centre, f. 10.

<sup>19</sup> Ligji nr. 8417 datë 21.10.1998 "Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë", e ndryshuar, Neni 57.

<sup>20</sup> Omari, L. & Anastasi, A. (2017). E drejta kushtetuese. Tiranë: Dajti 2000, f. 165-166.

<sup>21</sup> Ligji nr. 8417 datë 21.10.1998 "Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë", e ndryshuar, Neni 57 (5) "Arsimi i detyrueshëm, si dhe arsimi i mesëm i përgjithshëm në shkollat publike ofrohet falas."

Një karakteristikë tjetër e të drejtës për arsim garantuar nga Kushtetuta është dhe karakteri pluralist i arsimit. Kjo karakteristikë e sistemit arsimor vendas lejon prindërit të zgjedhin institucionin ku do të edukojnë fëmijët e tyre, i cili mund të jetë publik ose privat, laik ose fetar etj<sup>22</sup>. Përzgjedhja e institucioneve arsimore në bazë të vullnetit të prindërve është një mundësi e cila u rikthye pas ndryshimit të sistemit politik në vitet 1990, pasi sikurse u përmend dhe më lart gjatë periudhës komuniste sistemi arsimor ishte monist. Karakteri plural i kësaj të drejte përfshin mundësinë e prindërve për të arsimuar fëmijët sipas bindjeve të tyre filozofike ose fetare, duke respektuar këtu dhe laicitetin e shkollës publike.

Në të njëjtën linjë kuadri ligjor kushtetues, konkretisht neni 20 (2)<sup>23</sup>, garanton të drejtën e minoriteteve/pakicave të arsimohen në gjuhën e tyre. Pra, neni 57 i Kushtetutës duhet lexuar së bashku me dispozita të tjera të saj, të cilat garantojnë të drejtat e pakicave. Rregullimi i detajuar për të drejtën e pakicave për t'u arsimuar në gjuhën amtare bëhet me ligj të posaçëm. Gjithsesi, realizimi praktik i arsimimit në gjuhën e pakicave kërkon marrjen e masave nga ana e organeve të administratës.<sup>24</sup>

Për të jetësuar *de facto* të drejtën dhe detyrimin për arsim kuadri ligjor kushtetues garanton aksesin në sistemin arsimor të çdo qytetari, që mbush moshën e parashikuar. Kjo garanci bën të mundur mbrojtjen nga diskriminimi mbi çdo lloj shkak. Megjithatë, zbatimi i kësaj të drejte kërkon një kombinim masash ligjore dhe ekonomike, me qëllim mos përjashtimin e asnjë qytetari nga kjo e drejtë<sup>25</sup>.

---

<sup>22</sup> Ibid, Neni 57 (6) Nxënësit dhe studentët mund të arsimohen edhe në shkolla jopublike të të gjitha niveleve, të cilat krijohen dhe funksionojnë në bazë të ligjit.

<sup>23</sup> Ibid, neni 20 (2) [...] Ata kanë të drejtë t'i ruajnë e zhvillojnë ato, të mësojnë dhe të mësohen në gjuhën e tyre amtare si dhe të bashkohen në organizata e shoqata për mbrojtjen e interesave dhe të identitetit të tyre.

<sup>24</sup> Omari, L. & Anastasi, A. (2017). *Cituar më lart*, f. 168.

<sup>25</sup> Miço, H. (2012). *Zhvillimi i legjisllacionit arsimor shqiptar në shoqërinë demokratike*, f. 4-5.

### 1.3 Historik i shkurtër mbi rregullimin e të drejtës për arsim gjatë viteve 1990-2012

Me ndryshimin e sistemit politik në Shqipëri në fillim të viteve 1990 lindi nevoja për reforma legjislative në çdo fushë, duke përfshirë këtu edhe sistemin arsimor. Gjatë periudhës 1990-2012 janë miratuar 3 ligje kryesore për organizimin dhe funksionimin e sistemit arsimor përkatësisht në vitet 1992, 1995 dhe 2021.

Ligji i parë<sup>26</sup> ishte ai nr. 7635 datë 11.11.1992, i cili solli ndryshime në ligjin ekzistues të 1969 “Për sistemin e ri arsimor”. Ky ligj natyrisht revokoi qasjen politike dhe idelogjinë komuniste nga kurrikula arsimore. Gjithashtu, ai u fokusua në detyrimin për të ndjekur shkollën, pasi në fillim të viteve ‘90 u vërejt një braktisje e arsimit në shkallë vendi. U parashikuan dhe masa administrative për drejtorët e drejtorive arsimore dhe shkollave për mos gjurmimin e rasteve të braktisjes. Megjithatë, zbatimi në praktikë i këtyre parashikimeve të ligjit nuk u krye<sup>27</sup>.

Ligji amendues u shfuqizua më pas në vitin 1995 nga ligji “Për sistemin arsimor para universitar”<sup>28</sup>, qëllimi i të cilit ishte të reformonte sistemin arsimor shqiptar konform legjislacioneve evropiane. Risi kryesore e këtij ligji ishte mbështetja e sistemit arsimor dhe të drejtës për arsim mbi parimet e të drejtave dhe lirive themelore të njeriut, si dhe të drejtës ndërkombëtare të zbatueshme në Republikën e Shqipërisë<sup>29</sup>. Parimet e tij u reflektuan dhe në sanksionimin kushtetues që iu bë të drejtës për arsim. Ligji lejoi pluralitetin sa i takon ofruesve të arsimit, duke mundësuar licencimin e operatorëve privatë laik ose fetar. Ai reflektonte parimet e të drejtës për të aksesuar sistemin

<sup>26</sup> Ligji nr. 7635 datë 11.11.1992 “Për disa ndryshime në ligjin nr. 4624 datë 24.12.1969 “Për sistemin e ri arsimor”.

<sup>27</sup> Miço, H. (2012). *Cituar më lart*, f. 6-7.

<sup>28</sup> Ligji nr. 7952 datë 21.6.1995 “Për sistemin arsimor parauniversitar”.

<sup>29</sup> Miço, H. (2012). *Cituar më lart*, f. 8-9.

arsimor falas dhe në mënyrë të barabartë për të gjithë fëmijët, arsimin në gjuhën shqipe si dhe të drejtën e pakicave për arsimim në gjuhën e tyre. Gjithsesi, e drejta për arsim në gjuhë amtare e pakicave ishte rregulluar dhe më herët me Vendim të Këshillit të Ministrave<sup>30</sup>. Pavarësisht ndryshimeve në legjislacion dhe risive të sjella mbeti ende sfidë frekuentimi i shkollës nga nxënësit, si dhe rritja e cilësisë në mësimdhënie<sup>31</sup>. Infrastruktura e shkollave në të gjitha nivelet mbeti ende e moderuar duke mos përmbushur kështu nevojën gjithnjë e në rritje për një sistem arsimor bashkëkohor dhe në përputhje me standardet e modelet Evropiane. Nëse i referohemi monitorimit të progresit të bërë nga Shqipëria në lidhje me zbatimin në praktikë të së drejtës për arsim vërehet një situatë konstante problematikash.

Për vitin 2002 Komisioni Evropian në raportin e progresit u shpreh se reformave në fushën e edukimit duhet të avancinin dhe të ishin të qëndrueshme, me qëllim rritjen e cilësisë në këtë drejtim. Pavarësisht ekzistencës së kuadrit ligjor rregullues e drejta e minoriteteve për tu arsimuar në gjuhën e tyre duhet të mbetj në fokus të ekzekutivit pasi zbatimi i saj në praktikë karakterizohej nga mangësitë<sup>32</sup>. Mesatarja e shkollimit në Shqipëri në 2003 u vlerësua me 8.5 vjet arsimim, një shifër kjo më e ulët se pjesa më e madhe e vendeve ekonomitë e të cilave gjendeshin në tranzicion. Problematikë e madhe gjatë kësaj periudhe, sikurse përmendëm më lart, ishte frekuentimi i shkollës së mesme (38.7% në 2002 krahas 79% në 1990), shifër kjo mjaft më e ulët se vendet e rajonit. Shpenzimet buxhetore akorduar arsimit kapnin vetëm vlerën e 2.8% të PBB-së në 2003 krahasuar me 5% të saj në 1991<sup>33</sup>. Situata

<sup>30</sup> Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 396 datë 22.8.1994 "Për arsimin 8 vjeçar në gjuhën amtare të pakicave".

<sup>31</sup> Miço, H. (2012). *Cituar më lart*, f. 8-9.

<sup>32</sup> European Commission. (2002). *Progress Report made by Albania during 2002*, p. 10.

<sup>33</sup> European Commission. (2003). *Progress Report made by Albania 2003*, p. 31-32.

ndjeu disi përmirësim gjatë vitit 2005 ku mesatarja e ndjekjes së arsimit u rrit në 9.6 vjet, por ende mbeti 5 vjet më poshtë se mesatarja e vendeve OECD-së. Problematika serioze u evidentuan dhe në zbatimin e të drejtës për arsim mes femrave dhe meshkujve, ku më të disavantazuara mbetën fëmijët vajza në zonat rurale. Gjatë këtyre viteve është vërejtur dhe mangësi sa i takon aftësive të të arsimuarve shqiptar përballë nevojave të tregut të punës, mangësi këto që do të kërcënonin investimet në një periudhe afat-mesme<sup>34</sup>. Arritje pozitive në fushën e arsimit dhe të drejtës për edukim u evidentuan në vitin 2006, ku buxheti për këtë sektor u rrit ndjeshëm dhe u hartuan politika zhvillimi deri në vitin 2015. Në këtë vit u prezantua dhe sistemi i provimeve të Maturës Shtetërore, si dhe u përmirësua cilësia e mësimdhënies përmes kualifikimit të vazhdueshëm të mësuesve<sup>35</sup>. Progresi në sektor vazhdoi të mbetej modest, pa varësisht investimeve në infrastrukturë dhe kjo reflektoj edhe me numrat ende të lartë të braktisjes së arsimit<sup>36</sup>. Në 2010 kurrikula e arsimit të detyrueshëm dhe të mesëm, u rishikua me qëllim respektimin e të drejtës së minoriteteve dhe grupeve vulnerabël për t'u arsimuar. Megjithatë, BE-ja evidentoi nevojën për forcimin e kuadrit ligjor në lidhje me sigurimin e të drejtës për arsim të fëmijëve me nevoja të veçanta dhe grupeve vulnerabël. Shqipëria ende nuk ishte pjesë e platformave të testimit ndërkombëtar si testi OECD PISA ose baza e të dhënave e UNESCO-s<sup>37</sup>.

Përmirësime në sektorin e arsimit dhe garantimin e të drejtës për arsim u vërejtën në vitin 2011 ku ndër të tjera Shqipëria nisi punën për përfshirjen në Programin e Anketimit Ndërkombëtar të Studentëve (PISA)<sup>38</sup>.

---

<sup>34</sup> European Commission. (2006). *Progress Report made by Albania 2006*, p. 29-30.

<sup>35</sup> European Commission. (2007). *Progress Report made by Albania 2007*, p. 33-34.

<sup>36</sup> European Commission. (2008). *Progress Report made by Albania 2008*, p. 34-35.

<sup>37</sup> European Commission. (2010). *Progress Report made by Albania 2010*, 104-105.

<sup>38</sup> European Commission. (2011). *Progress Report made by Albania 2011*, p. 61.

Në përfundim, nëse do të përmblihdhnim situatën e sistemit arsimor dhe respektimin e të drejtës për arsim gjatë periudhës 1995-2012 mund të theksojmë se rregullimet ligjore përfshinë garantimin e parimeve dhe të drejtave themelore, megjithatë mbetej ende shumë punë për t'u bërë që e drejta për arsim të realizohej në praktikë sikurse parashikohej në legjislacion.

### 1.4.1 Kuadri ligjor në fuqi mbi Sistemin Parauniversitar të Zakonshëm

Arritja dhe respektimi i standardeve në kuadër të integritetit të Shqipërisë në Bashkimin Evropian në përgjithësi, si edhe përmbushja e detyrimeve të Marrëveshjes së Stabilizim Asociimit hyrë në fuqi në 2009 për përafrimin e legjislacionit, sollën nevojën për reformim të kuadrit ligjor rregullues për arsimin parauniversitar. Kështu, në vitin 2012 u miratua ligji nr. 69/2012 “Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë”<sup>39</sup>. Miratimi i këtij ligji pati qëllim garantimin e të drejtës kushtetuese për arsim, sipas kuadrit ligjor përkatës dhe funksionimin e sistemit parauniversitar<sup>40</sup>. Parimet dhe rregullimet specifike të ligjit janë tërësisht të përafruara me Kartën e të Drejtave Themelore të Bashkimit Evropian<sup>41</sup>. Ligji thekson dhe një herë garancitë e të drejtës për arsim në sistemin shqiptar si e drejtë kushtetuese për shtetasit shqiptar, të huajt dhe peronat pa shtetësi, duke mbrojtur ata nga diskriminimi për çdo lloj shkak. Gjithashtu, garantohet arsimi falas publik për arsimin e detyrueshëm dhe të mesëm<sup>42</sup>.

<sup>39</sup> Ligji nr. 69 datë 21.6.2012 “Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar.

<sup>40</sup> Ibid, neni 2 “[...] Qëllimi i këtij ligji është garantimin e të drejtës kushtetuese për arsim, sipas kuadrit ligjor përkatës dhe funksionimin e sistemit parauniversitar. [...]”.

<sup>41</sup> Karta e Lirive dhe të Drejtave Themelore të Bashkimit Evropian (2000/C 364/01), datë 18.12.2000.

<sup>42</sup> Ligji nr. 69 datë 21.6.2012 “Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë”, neni 5.



*Parimet më të rëndësishme<sup>43</sup> të mbrojtura nga ligji janë:*

- Respektimi dhe promovimi i lirive dhe të drejtave themelore të njeriut;
- Respektimi dhe promovimi i të drejtave të fëmijëve;
- Sistem arsimor laik, jo politik dhe plural;
- Mbrojtjen e interesit më të lartë të nxënësve;
- Mbrojtja nga diskriminimi për çdo lloj shkak, nga dhuna, keqtrajtimi fizik ose moral;
- Garantimi i të drejtës për arsim cilësor dhe shanse të barabarta;
- Gjithëpërfshirja dhe akses;
- Kujdes i veçantë për nxënësit e familjeve në nevojë dhe me aftësi të kufizuara fizike dhe mendore;
- Përfshirja e prindërve, nxënësve dhe mësuesve në përmirësimin e cilësisë së sistemit arsimor;
- Njohja e decentralizimit dhe autonomisë së institucioneve arsimore.

Ligji përmend në mënyrë të veçantë mbrojtjen nga diskriminimi për çdo lloj shkak dhe të drejtën e pakicave për t'u arsimuar në gjuhën e tyre amtare, si dhe e drejta e fëmijëve shqiptarë jashtë vendit për të përfituar nga programet e posaçme të arsimimit në gjuhën shqipe.

Në kuadër të respektimit të garancive kushtetuese dhe parimeve të parashikuara në ligjin e posaçëm për arsimin parauniversitar edhe institucionet shtetërore, që mbrojnë të drejtat e njeriut kanë një praktikë të konsoliduar në këtë drejtim, Avokati i Popullit dhe Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi. Disa nga këto vendimmarrje do i paraqesim në vijim për një pjesë të parimeve, që garantoohen nga ligji për arsimin parauniversitar.

---

<sup>43</sup> Parimet kryesore parashikohen në nenet 6-11 të ligjit nr. 69/2012.

- Kujdes i veçantë për nxënësit e familjeve në nevojë dhe me aftësi të kufizuara fizike dhe mendore

**SHEMBULL:** Pas një kronike në median vizive në dhjetor 2017 dhe duke vlerësuar ankesën e drejtorit të Institutit të Nxënësve që nuk shikojnë “Ramazan Kabashi”, Seksioni i Mbrojtjes dhe Promovimit të të Drejtave të Fëmijëve pranë Institucionit të Avokatit të Popullit kreu një inspektim në këtë institut. Objektivat e inspektimit ishin: vlerësimi i kushteve, mjediseve ku ofrohen shërbimet për fëmijët që nuk shikojnë, si dhe respektimi i të drejtave të të fëmijëve në zbatim të Konventës për Mbrojtjen e të Drejtave të Fëmijëve.

Avokati i Popullit shprehu shqetësim lidhur me kapacitetin e dobët në përgjithësi lidhur me zbatimin efektiv të ligjeve që trajtojnë çështje të fëmijëve në nivele rajonale dhe ato bashkiake ku mungon fryma e bashkëpunimit e bashkërendimit të punës me strukturat e tjera të ngritura për mbrojtjen e fëmijëve Njësia për Mbrojtjen e Fëmijës (NJMF) të cilat do të garantojnë të drejtat e fëmijëve në interesin më të lartë të tyre. Kështu AP rekomandoi marrjen e masave për:

- të parashikuar në planin buxhetor për vitin 2018 blerjen e sendeve të nevojshme për sigurimin e kushteve minimale të jetesës për institutin e nxënësve që nuk shikojnë Tiranë;
- vlerësimin dhe miratimin e rregullores së për institutin e nxënësve që nuk shikojnë Tiranë nga Drejtoria Arsimore Tiranë;
- hartimin e akteve ligjore në zbatim të pikës, 1 dhe 6, të nenit 64, të ligjit nr. 69/2012 “Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar në lidhje me ndjekjen e institucioneve arsimore nga fëmijët me aftësi të kufizuara;
- të përcaktuar kriteret e vlerësimit të aftësisë së kufizuar nga komisioni multi-disiplinor të njësive

vendore arsimore në përputhje me standardet e vlerësimit të ICF - Klasifikimi Ndërkombëtar për Aftësinë e Kufizuar” të hartuar nga Organizata Botërore e Shëndetësisë (OBSh) për të garantuar përfshirjen dhe integrimin e fëmijëve me aftësi të kufizuar pranë shkollave publike të njësive vendore ku ata jetojnë.

- të garantuar pjesëmarrjen e fëmijëve në vendimarrje në të gjitha procedurat, programet dhe projektet që ndërmerren në institucion dhe që ndikojnë tek ta në institutin e nxënësve që nuk shikojnë “Ramazan Kabashi”, Tiranë duke u përfshirë dhe problematika e publikuar me mediat vizive.
- të bashkëpunuar dhe bashkërenduar punën me mekanizmat e ngritur në nivel vendor (NJMF) në zbatim të Udhëzimit nr.10, datë 25.2.2015 “Për mënyrat, format e bashkëpunimit dhe procedurat e ndërhyrjes në ndihmë të fëmijëve në rrezik për institucionet dhe strukturat kryesore përgjegjëse për mbrojtjen e fëmijës”.

**SHEMBULL:** Në vendimin nr. 40/2018 të Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi (KMD), kërkuesja ka pretenduar diskriminim të fëmijës së saj për shkak të aftësisë së kufizuar mendore. Sipas vendimit të Komisionit Multi-disiplinar të Drejtorisë Arsimore Rajonale Korçë të vitit 2015, fëmija i kërkueses duhet të asistohet gjatë procesit mësimor në klasë nga një mësues ndihmës. Megjithatë, sipas pretendimeve të kërkueses fëmija nuk ka pasur asnjëherë një mësues të tillë. Pas kërkesave të vazhdueshme në D.A.R Korçë, kërkuesja është informuar se institucioni nuk mund t'i përgjigjej kësaj kërkesë për shkak të problemeve buxhetore. KMD-ja vendosi se në këtë rast kemi një diskriminim të drejtpërdrejtë, të nxënësës A. G., për shkak të aftësisë së kufizuar, nga ana e drejtorisë së Shkollës 9-vjeçare “Sotir Gurra”, Korçë, duke mos i ofruar asistencë me mësues ndihmës në procesin mësimor të të nxënës, si dhe përmes mosvlerësimit të ecurisë

së nxënëses gjatë periudhës që ajo ka ndjekur këtë shkollë. Drejtoria e shkollës dhe D.A.R Korçë duhet të merrnin masa të menjëhershme, për plotësimin e kërkesës në fjalë dhe të shmangin situata të tilla diskriminuese në të ardhmen ndaj kategorisë së nxënësve me aftësi të kufizuara.

- Mbrojtja nga diskriminimi për çdo lloj shkak, nga dhuna, keqtrajtimi fizik ose moral

**SHEMBULL:** Në vendimin nr. 58/2019 të KMD-së, organizata kërkuese Qendra Evropiane për të Drejtat e Romëve<sup>44</sup> pretendoi se Shkolla 9-vjeçare “Liria” është një shkollë e segreguar, e frekuentuar kryesisht nga nxënësit e komunitetit romë dhe egjiptian, me vetëm një numër të kufizuar nxënësish jo romë/egjiptianë. Rezulton se fëmijët romë dhe egjiptianë të kësaj shkolle janë të përjashtuar nga mësimi i integruar, gjë që e bën të vështirë integrimin e tyre në shoqëri. ERRC theksoi faktin se institucionet përgjegjëse nuk kanë marrë masa të mjaftueshme, për të luftuar diskriminimin nëpër institucionet mësimore. Kjo shkollë, e cila funksionon që prej vitit 2007, pavarësisht qëllimit si një shkollë e ngritur afër komunitetit, me qëllim rritjen e frekuentimit të procesit mësimor nga nxënësit romë dhe egjiptianë, ka ndihmuar në përfundim të segregimit. KMD konstatoi për këtë rast diskriminimin në formën e segregimit, nga ana e DAR Shkodër, për shkak të “racës”, së nxënësve romë dhe egjiptianë, që mësojnë pranë Shkollës 9-vjeçare “Liria” Shkodër dhe Shkollën vartëse “Isuf Tabaku”, Ajasëm, Shkodër. Gjithashtu, Komisioneri vendosi duhet të merreshin masa të nevojshme nga D.A.R Shkodër, për shmangien e situatës së segregimit, duke zbatuar Dispozitat Normative, në lidhje me zbatimin e kriterit të regjistrimit të nxënësve sipas zonës së shkollës. Në vazhdim KMD urdhëroi marrjen e masave nga ana e DAR Shkodër, drejtuesit e shkollave në këtë

<sup>44</sup> European Roma Rights Centre ERRC.

qark, nën mbështetjen dhe asistencën e ERRC-së dhe organizatave të tjera, për kryerjen procesit informues me familjet rome dhe egjiptiane, mbi segregimin dhe pasojat e tij në arsim.

**SHEMBULL:** Në vendimin nr. 14/2015 Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi trajtoi ankimin e shtetasës J.R., e cila pretendonte diskriminim për shkak të bindjeve fetare nga drejtorja e gjimnazit të mesëm të përgjithshëm “M. çollaku” Pogradec. Kërkesja u mbulua pas përfundimit të klasës së 10 dhe drejtorja e shkollës i mohoi të drejtën të ndiqte mësimin për vitin akademik 2014-2015. Shkolla e arsyetoi vendimmarrjen e saj bazuar në faktin se institucionet arsimore dhe shtetërore në Shqipëri janë laike dhe nuk mund të përdoren simbole fetare në institucione publike. KMD vërejti se Kushtetuta dhe ligji u garanton të drejtën për arsimim gjithë shtetasve shqiptarë, të huaj dhe personave pa shtetësi pa u diskriminuar për asnjë lloj shkakut përfshirë dhe fenë. Gjithashtu, KMD vërejti se në zbatim të parashikimeve të ligjit në fuqi “Për sistemin parauniversitar” interesi i nxënësve është parësor. Në këtë rast KMD konstatoi diskriminim të drejtpërdrejtë për shkak të bindjeve fetare dhe urdhëroi shkollën të lejonte kërkesën të ndiqte vitin akademik. KMD rekomandoi Ministrinë e Arsimit të amendojë ligjin “Për sistemin parauniversitar” me qëllim përcaktimin më të saktë të të drejtave dhe detyrave të nxënësve.

- Gjithëpërfshirja dhe akses

**SHEMBULL:** Një çështje e trajtuar nga institucioni i Avokatit të Popullit pas marrjes së ankesës, ka qenë rasti i prindit të fëmijës E.B, në lidhje me përjashtimin nga shkolla e mesme e përgjithshme “Oso Kuka”, Shkodër si rezultat i mungesës së certifikatës personale. Avokati i Popullit mori në shqyrtim ankesën në bazë të nenit 16 të Kushtetutës për të drejtat e qytetarëve që jetojnë në Republikën e Shqipërisë dhe pikës 3, të nenit 57, ku garantohet se “Arsimi i mesëm i përgjithshëm publik është i hapur për të gjithë”, si edhe në zbatim të nenit 16, të ligjit nr. 10347/2010

“Për mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve”. Pas hetimit administrativ AP rekomandoi regjistrimin e B.B në shkollën e mesme të përgjithshme “Oso Kuka” në respektim të të drejtës së tij kushtetuese, si edhe referimin e rastit në Njësinë për Mbrojtjen e Fëmijëve, Shkodër për hartimin e planit të mbrojtjes së fëmijës për të mundësuar regjistrimin e fëmijës në gjëndjen civile.

**SHEMBULL:** Një rast i shqyrtuar nga institucioni i Avokatit të Popullit është situata e krijuar për pajisjen me libra falas të fëmijëve të komunitetit egjiptian në shkollën “Azem Hajdari”, Babrru, Tiranë. M. L., e cila është pjesë e komunitetit egjiptian ka informuar AP se pavarësisht nisjes së vitit akademik fëmijët e saj nuk ishin pajisur me libra nga drejtori shkollës “Azem Hajdari”. Në zbatim të kornizës kushtetuese dhe ligjore në fuqi, si dhe Udhëzimit Nr. 16, datë 3.8.2016 për vitin shkollor 2016-2017 “Në sistemin arsimor parauniversitar të gjithë fëmijët e komunitetit rom dhe egjiptian gëzojnë të drejtën për tu pajisur me libra falas”, AP rekomandoi marrjen e masave për pajisjen me libra shkollorë falas për fëmijët e shtetasës së komunitetit egjiptian M. L. dhe shmangien e shkeljeve të tjera të kësaj natyre.

### ***Kategorizimi i arsimit parauniversitar***

Ligji kategorizohen nivelet e arsimit në parashkollor, bazë dhe i mesëm i lartë me një strukturë 6+3+3 vite, efektet e para të të cilit u dhanë pas vitit shkollor 2015-2016<sup>45</sup>.

**Arsimi parashkollor** - Edukimi parashkollor përbëhet nga çerdhet e kopshtet private ose publike. Çerdhet janë institucione në vartësi të pushtetit vendor dhe përfshijnë fëmijë të grup moshës (0 - 3) vjeç. Kopshtet janë institucione në vartësi të MASR dhe përfshijnë fëmijë të grup moshës (3 - 6) vjeç. Arsimi parashkollor nuk është i detyruar. Procesi mësimor educa-

---

<sup>45</sup> Strategjia e Arsimit Parauniversitar 2012-2020, Fletore Zyrtare nr. 2/2016, f. 18.

tiv në arsimin parashkollor zhvillohet mbi bazën e programeve të miratuara nga MASR<sup>46</sup>.

**Arsimi bazë** - i detyruar synon të zhvillojë aftësitë intelektuale, krijuese, praktike dhe fizike të nxënësve, të zhvillojë personalitetin e tyre dhe t'i pajisë ata me elementet themelore të kulturës së përgjithshme dhe edukatën qytetare. Arsimi bazë i detyruar fillon në moshën 6 vjeç, zgjat 9 vjet dhe përbëhet nga cikli fillor (klasa 1-5) dhe cikli i mesëm i ulët (klasa 6-9). Nxënësit janë të detyruar të ndjekin arsimin bazë deri në moshën 16 vjeç<sup>47</sup>.

**Arsimi mesëm** - përbëhet nga gjimnazet (me kohë të plotë dhe të pjesshme) si dhe nga shkollat e mesme profesionale. Ky cikël nuk është i detyruar. Në shkollat publike ai ofrohet falas. Ky cikël ka qëllim të japë një kulturë të përgjithshme dhe është zgjerim i njohurive e thellim i kulturës e njohurive të fituara në shkollat e arsimit bazë. Kohëzgjatja e gjimnazit është 3 vjet dhe përfundon me provimet e Maturës Shtetërore. Kurrikula e gjimnazit është e përbërë nga kurrikula bërthamë dhe kurrikula me zgjedhje<sup>48</sup>.

Një risi e ligjit për sistemin parauniversitar në vend është dhe pjesëmarrja e prindërve në sistemin arsimor. Prindërit kanë të drejtë të organizohen në një sërë strukturash, që lidhen drejtpërdrejtë me funksionimin e shkollës të tilla si bordi i shkollës, këshilli i prindërve etj. Ata kanë të drejtë të shprehin dhe argumentojnë pikëpamjet e tyre mbi cilësinë e mësimdhënies/kurrikulës, pikëpamje këto që duhet të merren në konsideratë nga institucioni sipas rastit<sup>49</sup>.

---

<sup>46</sup> Karameta, P. et.al (2014). *Reforma në sistemin arsimor parauniversitar: raport paraprak*, f. 8.

<sup>47</sup> Ibid.

<sup>48</sup> Ibid, f. 9.

<sup>49</sup> Mico, H. & Zaçellari, M. (2019). *Polish Journal of Educational Studies*: "Legal aspects of participation practices in the Albanian education Context", p. 96-97.

Me qëllim vazhdimin e reformave dhe konsolidimin e sistemit arsimor, pas miratimit të ligjit dhe zbatimit të tij për disa vjet, ekzekutivi shqiptar miratoi dokumentin politik, që paraqet vizionin e sistemit arsimor parauniversitar: Strategjia e Arsimit Parauniversitar (SAPU) 2014-2020 dhe Plani i saj i Veprimit. Struktura e SAPU-së është vizioni i përgjithshëm, objektivat, rezultatet dhe aktivitetet për arritjen e këtyre rezultateve.

Ky dokument politik ka vizion pasjen e një sistemi arsimor me në qendër nevojat dhe interesat e nxënësve, ku dijet e përfuturara përmes parimit të të nxënësve gjatë gjithë jetës të shërbejnë dhe janë konform kërkesave për mirëqenie, zhvillim të qëndrueshëm dhe globalizimit<sup>50</sup>. Strategjia vendosi 4 objektiva kryesore<sup>51</sup> për përmbushjen e vizionit të saj:

- a. Përsosja e qeverisjes, udhëheqjes dhe menaxhimit të kapaciteteve dhe burimeve të Sistemit Arsimor Parauniversitar.
- b. Nxënia cilësore dhe gjithëpërfshirëse.
- c. Sigurimi i cilësisë i bazuar në standarde të krahasueshme me vendet e BE-së.
- d. Përgatitja dhe zhvillimi profesional bashkëkohor i mësuesve dhe i drejtuesve.

Monitorimi i bërë ndaj SAPU-së në 2019 ka evidentuar disa nga gjetjet dhe problematikat kryesore të hasura gjatë zbatimit të strategjisë:

- Arsimi ndeshet ende me nivele të pakënaqshme financimi;
- Decentralizimi ka potencialin të përmirësojë efikasitetin dhe llogaridhënien në menaxhimin dhe qeverisjen e sistemit arsimor;

---

<sup>50</sup> Ibid, f. 27-28.

<sup>51</sup> Ibid.



- Drejtuesit e shkollave shihen si ura të dobëta lidhëse brenda sistemit;
- Ka përmirësim sa i takon të drejtës për të aksesuar shkollën;
- Duhet bërë akoma më shumë punë lidhur me hartimin e programeve arsimore për fëmijërinë e hershme;
- Prioritet duhet të vendoset në aspektet cilësore të arsimit, si edhe përdorimit të TIK;
- Vendi nuk ka një procedurë që të sigurojë monitorimin gjithëpërfshirës të performancës së sistemit arsimor.
- Duhet kushtuar më shumë vëmendje trajnimit të vazhdueshëm të mësuesve.

Progresi në sistemin arsimor parauniversitar të zakonshëm është vërejtur dhe në progres raportet e Komisionit Evropian për Shqipërinë, ku raporti i fundit cilësoi se ka pasur arritje në lidhje me vlerësimin e politikave, kurrikulës dhe kuadrit ligjor. Ka pasur një rritje të numrit të regjistrimeve të nxënësve me prejardhje Rome dhe Egjiptiane pavarësisht se ekziston ende një diferencë e madhe në raport me regjistrimet e pjesës tjetër të fëmijëve<sup>52</sup>. Ndërprerja e shkollës për shkak të pandemisë COVID-19 dhe tërmeti i ndodhur në nëntor 2019 treguan problematikat, mangësitë dhe sfidat e sistemit arsimor shqiptar sa i takon edukimit në distancë. Në vazhdim do të bëjmë një analizë të ecurisë dhe sfidave të arsimit dhe formimit profesional, me qëllim krijimin e një panorame më të qartë mbi të gjithë hallkat e sistemit arsimor parauniversitar në vend dhe garantimit të të drejtës për arsimim në terma konkret.

---

<sup>52</sup> European Commission. (2020). *Albanian Progress Report 2020*, p. 100-102.

## 1.4.2 Kuadri ligjor në fuqi mbi Arsimin dhe Formimin Profesional

Në kuadër të ushtrimit të së drejtës së tyre për të zgjedhur llojin e edukimit, që ndjekin pas përfundimit të arsimit bazë të detyruar, sistemi arsimor vendas u mundëson nxënësve të ndjekin arsimin e mesëm profesional [dhe formimin] për t'u përfshirë më herët në tregun e punës.

Arsimi dhe Formimi Profesional është një fushë e aftësive profesionale, e cila pajis nxënësit me njohuri dhe shprehje të veçanta si dhe me kompetenca të gjera që kërkohen për t'u punësuar në një profesion të caktuar dhe për t'u integruar në tregun e punës. Shkollat e Mesme Profesionale në Shqipëri kanë nisur të funksionojnë në fillim të viteve 1920, në një kohë ku gati 80% e popullsisë ishte analfabete. Shkolla e parë profesionale u themelua më 1921 nga Kryqi i Kuq amerikan me emrin "Harry Fultz" dhe kishte profil teknik.

Sikurse u përmend më lart, pas Luftës së Dytë Botërore momenti në të cilin ndodhej vendi, veçanërisht sektori industrial dhe kooperativat kishin mjaft nevojë për teknikë të kualifikuar. Kështu, sistemi i kohës krijoi një arsim profesional dual: së pari shkollat profesionale ofronin edukim teorik, më pas nxënësit ndiqnin praktikën profesionale në ndërmarrjet shtetërore. Këto praktika rregulloheshin me ligj dhe siguroheshin nga shteti<sup>53</sup>. Në linjë dhe me relievin gjeografik të vendit rreth 58% e të gjithë shkollave profesionale gjatë periudhës komuniste ishin të profilit teknik-bujqësor<sup>54</sup>. Në këtë periudhë u hapën 380 shkolla të mesme profesionale pjesa më e madhe e të cilave u vendosën në Tiranë. Ndërkohë pjesa tjetër nisën

<sup>53</sup> Jager, M. (...). *Meandering through Policy Development: Observations on Vocational Education and Training in Albania*, p. 1.

<sup>54</sup> <https://konica.al/2018/10/retrospektive-shkollat-profesionale-ne-kohen-e-komunizmit/> [konsultuar më 01.10.2020].

të funksiononin në qytete me numër të madh popullsie ose qytete industriale<sup>55</sup>.

Sistemi aktual i arsimit profesional është i ndarë në dy kategori kryesore: *Shkollat e Mesme Profesionale (ShMP) dhe Qendrat e Formimit Profesional (QFP)*.

Shkollat e Mesme Profesionale - Arsimi fillestar profesional parashikon tre nivele si arsimin e përgjithshëm ashtu dhe atë profesional (teorik dhe praktik), duke i përgatitur personat që e zgjedhin për punë dhe arsim të mëtejshëm.

**Niveli I** - parashikon një program dyvjeçar për formimin e punëtorëve gjysmë të aftësuar. Nxënësit marrin një certifikatë bazë të formimit profesional dhe mund të hyjnë në tregun e punës ose të vazhdojnë studimet e tyre në nivelin pasardhës.

**Niveli II** - parashikon një program njëvjeçar që përgatit teknikë dhe i pajis me certifikata të formimit pasardhës.

**Niveli III** - parashikon një program njëvjeçar tekniko-profesional që zgjat edhe një vit më shumë dhe ju hap rrugën për arsimin e lartë. Në fushën e Arsimit dhe Formimit Profesional ekzistojnë 29 drejtime të cilat janë të njohura nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë dhe Agjencia Kombëtare e Punësimit dhe Aftësive.

**Qendrat e Formimit Profesional** - janë institucione publike dhe jo-publike në të cilat ofrohen kualifikime afatshkurtra në nivel kombëtar ose qendror, nga 4 muaj e deri në 2 vjet, në profesione të kërkuara nga tregu i punës. Kurset profesionale në Nivel Kombëtar janë unike për të gjitha QFP në vend dhe janë kualifikime profesionale afatgjata (por jo më shumë se 2 vite).

---

<sup>55</sup> Ibid.

Kurset Profesionale në Nivel Qendre janë kurse specifike dhe ofrohen nga qendrat profesionale në funksion të kërkesave që kanë bizneset lokale, janë afatshkurtra dhe shërbejnë për kualifikime në procese të ndryshme teknologjike etj. Në përfundim të kurseve kombëtare, kursantët pajisen me certifikatë të unifikuar në të gjithë vendin.

Sipas Anketës zyrtare të Fuqisë Punëtore për vitin akademik 2017-2018, nxënësit e arsimit profesional, si përqindje zunë rreth 20.6% të gjithë nxënësve në arsimin e mesëm, krahasuar me 79.4% të arsimit të përgjithshëm<sup>56</sup>. Sa i përket përqindjes së punësimit të të diplomuarve të arsimit profesional, sipas Strategjisë Kombëtare për Aftësi dhe Punësim kjo vlerë ishte 25% në 2016. Ndërkohë, nuk ka të dhëna për vitin 2017. Sektori publik i AFP-së është shumë i vogël, por përqindja e regjistrimit të studentëve në AFP, në arsimin e mesëm, u rrit nga 13% në 2013 në mbi 20% në 2018<sup>57</sup>.

Shqipëria ka vazhduar zbatimin e detyrimeve, që rrjedhin nga Marrëveshja e Stabilizim-Asociimit si një kusht për të përmbyshur objektivin e saj strategjik të integritit në BE. Përafrimi i legjislacionit vendas me *acquis* të BE-së është një proces i gjatë, i cili jo vetëm që ka nevojë për mjete financiare, por edhe përmirësim të njohurive. Strategjia Kombëtare për Punësim dhe Aftësi (NESS)<sup>58</sup> 2014-2020 (rishikuar dhe azhurnuar deri në vitin 2022) është një nga instrumentet kryesore që synon t'i përgjigjet vizionit të direktivave të BE-së, Strategjisë Evropiane të Punësimit 2020 dhe gjithashtu përparësive të përcaktuara nga Komisioni i BE në kuadrin e integritit të Shqipërisë në BE. Vizioni i qeverisë shqiptare në këtë strategji është “*Shkathhtë-*

<sup>56</sup> <http://www.instat.gov.al/media/4621/statistika-t%C3%AB-regjistrimeve-n%C3%AB-arsim-2017-2018.pdf>, f.3 [konsultuar më 04.10.2020]

<sup>57</sup> National Employment and skills Strategy 2014-2020, *Annual Progress Report 2017*, table 27. Indicators for monitoring of key targets of NESS 2014-2020 (%), p. 81

<sup>58</sup> Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 818 dated 26.11.2014,

*si të larta dhe punë më të mira për të gjitha gratë dhe burrat*<sup>59</sup>, i cili detajohet më tej në katër objektiva strategjike. Midis tyre, Shtylla B i kushtohet përmirësimit të cilësisë në arsimin dhe aftësimin profesional, për të rinjtë dhe të rriturit. Kështu, përpjekjet për të rritur nivelet e regjistrimit në të gjitha nivelet arsimore, përfshirë regjistrimet në sistemin e AFP, janë një përparësi e vazhdueshme e Qeverisë Shqiptare. Gjithashtu, strategjia parashikon një numër masash të cilat do të ndihmojnë në përputhjen më të mirë të kërkesave të tregut.

Një tjetër dokument politik që parashikon masa për përmirësimin e situatës së brendshme në sistemin e arsimit dhe aftësimin profesional është Strategjia Kombëtare për Zhvillimin dhe Integrimin (2014-2020)<sup>60</sup>. Ajo ka për qëllim të rrisë cilësinë e arsimit përmes qëllimeve strategjike për reformimin dhe përmirësimin e sistemit të AFP për të ofruar aftësi që integrohen me kërkesat de facto të tregut të punës dhe për të zgjeruar numrin e studentëve që ndjekin studimet e AFP; dhe të zbatojë Kornizën Shqiptare të Kualifikimit (AQF) dhe të mësuarit gjatë gjithë jetës në sistemin e AFP-së<sup>61</sup>. Si indikator ishte parashikuar rritja e raportit ndërmjet pranimeve të reja në arsimin profesional dhe shkollave të mesme të përgjithshme në 33% dhe 67% në vitin 2020. Sipas të dhënave zyrtare të INSTAT për vitin akademik 2018-2019, raporti midis pranimeve të reja në AFP dhe në shkollat e mesme të përgjithshme është 18.3% kundrejt 81.7%. Duke iu referuar të njëjtave shifra, gjatë periudhës 2014-2018 numri i nxënësve që frekuentojnë shkollat e AFP është rritur vetëm 2%<sup>62</sup>. Si pasojë, përparësia strategjike e vendosur nga qeveria mund të konsiderohet ende ambicioze.

---

<sup>59</sup> Strategjia Kombëtare për Punësim dhe Aftësi 2014-2020, f.58

<sup>60</sup> Ibid.

<sup>61</sup> [https://www.oneplanetnetwork.org/sites/default/files/albania\\_national\\_strategy\\_on\\_development\\_and\\_integration.pdf](https://www.oneplanetnetwork.org/sites/default/files/albania_national_strategy_on_development_and_integration.pdf), Strategjia Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim (2014-2020), f. 90-91 [konsultuar më 05.10.2020]

<sup>62</sup> <http://www.instat.gov.al/al/temat/tregu-i-pun%C3%ABs-dhe-arsimi/arsimi/#tab2>, tabela 1 exel, [konsultuar më 05.10.2020]

Siç u përmend më lart, ligji kryesor për Profesionin dhe Arsimin dhe Trajnimin<sup>63</sup>, u miratua në vitin 2017. Ligji cakton shumë përgjegjësi për sigurimin e standardeve të kualifikimit, zhvillimin e një kurrikule të AFP dhe sigurimin e masave për ndërtimin e kapaciteteve për mësuesit. Në kuadër të zbatimit të ligjit, Shërbimi Kombëtar i mëparshëm i Punësimit (SHKP) është shndërruar në Agjencinë Kombëtare të Punësimit dhe Aftësive (AKPA)<sup>64</sup>, e cila ndër të tjera është përgjegjëse për menaxhimin e shkollave profesionale dhe qendrave të trajnimit<sup>65,66</sup>.

Siç është e qartë që numri i institucioneve publike të përfshira në funksionimin e sistemit të arsimit dhe aftësimit profesional në Shqipëri është i lartë. Gjegjësisht, këto organe janë: Ministria e Financave dhe Ekonomisë; Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë; Agjencia Kombëtare e Punësimit dhe Shkathtësive; Agjencia Kombëtare e Trajnimit dhe Kualifikimit të Arsimit Profesional; dhe Këshilli Kombëtar i Trajnimit Profesional dhe të Arsimit. Reforma për të përmirësuar arsimin dhe aftësimin profesional (AFP) është vonuar në implementimin dhe rezultatet e saj. Raporti Afatmesëm i Progresit 2014-2020<sup>67</sup>, botuar në fund të pranverës 2018, ku përveç ndikimit pozitiv të arritur, thekson një numër sfidash që janë përpara për qeverinë në mënyrë që të arrijë vizionin e saj strategjik. Ndër të tjera ky raport shef si thelbësore që:

- ❖ të vazhdojë të sigurojë cilësi dhe qasje të barabartë në AFP;
- ❖ të miratojë legjislacionin sekondar për ligjet mbi AFP, AQF dhe zejtarinë;

---

<sup>63</sup> Ligji nr. 15/2017 "Mbi arsimin dhe formimin profesional në Republikën e Shqipërisë", datë 16.2.2017.

<sup>64</sup> Ligji nr. 15/2017, neni 10.

<sup>65</sup> Ibid, neni 9.

<sup>66</sup> Vendosur me Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 554 datë 31.7.2019 "Mbi krijimin, organizimin dhe funksionimin e Agjencisë për Punësim dhe Aftësi".

<sup>67</sup> Mid-term Progress Report NESS 2014-2020, p. 82-83.

- ❖ të përmirësojë infrastrukturën dhe materialet mësimore;
- ❖ përfshirjen e sektorit privat si partner për të ofruar punë dhe praktika, gjë e cila do të ndihmojë edhe në akreditimin e praktikës, sigurimin e brendshëm të cilësisë dhe për ta bërë biznesin aktiv në hartimin e politikave dhe zbatimin e tregut të punës dhe politikave të AFP-së ;
- ❖ të bëjë përparim të mëtejshëm në shtrirjen e punësimit dhe shërbimeve të AFP-së në zonat rurale;
- ❖ të përfshijë sistemin e gjurmimit si mjete analize të tregut të punës të cilat do të ndihmojnë për të mbyllur hendekun midis kërkesave të punës dhe furnizimit të arsimit profesional.

Riorganizimi i AFP-ve si qendra shumë funksionale, siç përcaktohet nga ligji i ri i AFP-së<sup>68</sup> dhe forcimi i bashkëpunimit ndërinstitucional do të ndihmojnë, që reforma shqiptare e AFP-së të jetë më efikase. Procesi i “ndjekjes” së studentëve të diplomuar në AFP konfirmon integrimin e tyre në tregun e punës (46.9% të punësuar, 27.6% të papunë jo në arsim ose trajnim në vitin pas diplomimit). Miratimi i legjislacionit dytësor (aktet nënligjore) për ligjin e AFP-së është vonuar<sup>69</sup>.

Një zhvillim i mëtejshëm është miratimi i Ligjit për Nxitjen e Punësimit<sup>70</sup> që pritet të zhbloktojë ritmin e ngadaltë të reformës. Për më tepër, ka pasur zhvillime pozitive në formën e hapjeve të programeve të reja post-sekondare/jo-terciare dyvjeçare dhe ofrimit të trajnimit privat. Të dy kanë potencialin për tu zgjeruar më tej. Rregulloret për Kornizën Shqiptare të

---

<sup>68</sup> Laë no.15/2017 “On Vocational Education and Training in the Republic of Albania” dated on 16.2.2017.

<sup>69</sup> <https://data.consilium.europa.eu/doc/document/ST-8543-2019-INIT/en/pdf> , Albania Economic Reform Programe (ERP) - 2018-2020 Assesment, p.20

<sup>70</sup> Laë no. 15/2019 “On Employment Promotion”, dated on 13.3.2019, published in the Official Gazette no. 45 date 3.4.2019.

Kualifikimit (AQF) janë hartuar, por nuk janë miratuar ende, dhe kapacitetet për zbatimin e plotë të AQF aktualisht janë të dobëta<sup>71</sup>.

Një instrument shtesë thelbësor është Dokumenti Strategjik Tregues për Shqipërinë (2014-2020)<sup>72</sup>, përcakton përparësitë për ndihmën financiare të BE-së për periudhën 2014-2020 për të mbështetur Shqipërinë në rrugën e saj të pranimit. Pavarësisht progresit të bërë, Shqipëria ende përballet me sfida në sektorin e arsimit në përgjithësi, dhe sistemin e AFP-së në veçanti. Në Progres raportin e vitit 2020 për Shqipërinë, në lidhje me Arsimin dhe Formimin Profesional, vendi ynë ka arritur progres në zbatimin e rekomandimeve të raportit të mëparshëm në këtë fushë, veçanërisht në krijimin e një kornize politike për arsimin parashkollor në sektorin e Arsimit dhe Formimit Profesional. Progres u rregjistrua dhe me krijimin e Agjencisë Kombëtare të Punësimit dhe Aftësive, ristrukturimin e Agjencisë Kombëtare të Arsimit<sup>73</sup>, Formimit Profesional dhe Kualifikimeve, zbatimin e Ligjit vendas të Kualifikimit dhe në miratimin e legjislacionit zbatues për Ligjin e AFP. Në përgjithësi, Shqipëria paraqitet si mesatarisht e përgatitur në fushën e arsimit dhe kulturës<sup>74</sup>.

Korniza e rishikuar ligjore për Kualifikimin, e miratuar në vitin 2018, u plotësua me legjislacion sekondar për krijimin e komiteteve sektoriale të aftësive. Shqipëria aktualisht po përgatit referencën e saj në Kornizën Evropiane të Kualifikimit, që pritet të zhvillohet në 2021<sup>75</sup>. Vlerësimi i mësimin joformal dhe jo-

<sup>71</sup> <https://data.consilium.europa.eu/doc/document/ST-8543-2019-INIT/en/pdf> , Albania Economic Reform Programe (ERP) - 2018-2020 Assesment, p.20

<sup>72</sup> [https://ec.europa.eu/neighbourhood-enlargement/sites/near/files/pdf/key\\_documents/2014/20140919-csp-albania.pdf](https://ec.europa.eu/neighbourhood-enlargement/sites/near/files/pdf/key_documents/2014/20140919-csp-albania.pdf) [consulted on 5.11.2019].

<sup>73</sup> <https://shqiptarja.com/lajm/ristrukturimi-216-drejtore-sipas-br-varesise-ministri-per-ministri>.

<sup>74</sup> Progress-Report for Albania 2020, p.101.

<sup>75</sup> Progress-Report for Albania 2020, p.102.



formal është një nga masat prioritare në Strategjinë Kombëtare për Punësimin dhe Aftësitë 2014–2022 dhe është parashikuar në të dy ligjet si atë të AFP<sup>7677</sup> ashtu dhe në atë të QMF<sup>78</sup>. Zbatimi i këtyre masave deri më tani ka qenë i kufizuar vetëm për zonat pilot dhe nuk është zbatuar ende në të gjithë vendin.

Përkundër disa progreseve në vitin 2019, legjislacioni i zbatueshëm për Ligjin për AFP-në nuk është miratuar ende plotësisht. Standardet e kualifikimit dhe kurrikulat për shumicën e programeve të AFP janë duke u modernizuar, por disa shkolla nuk kanë aftësi dhe pajisje mësimore për t'i zbatuar ato në praktikë. Qeveria së fundmi ka racionalizuar institucionet e AFP, duke krijuar Agjencinë Kombëtare të Punësimin dhe Aftësive<sup>79</sup> dhe duke ristrukturuar më tej Agjencinë Kombëtare për AFP dhe Kualifikimet.

Sidoqoftë, në Raport shprehet se sfidat e zbatimit të reformave vazhdojnë dhe mbetet shumë për të bërë para se këto përpjekje të rëndësishme modernizimi të kenë dhënë një ndikim pozitiv në tregun e punës. Standardet e kualifikimit dhe kurrikulat për shumicën e programeve të AFP janë duke u modernizuar, edhe pse disa shkolla shqiptare nuk kanë aftësi mësimore dhe pajisje për t'i vënë në praktikë teorinë. Përkundër aktiviteteve promovuese dhe mbështetjes për studentët nga zonat rurale në ndjekjen e arsimit të AFP, pjesëmarrja në AFP është e ulët, në krahasim me vendet e tjera të rajonit, me vetëm 18.2%<sup>80</sup> të studentëve të mesëm të lartë të regjistruar në shkollat profesionale në vitin 2019.

<sup>76</sup> [http://financa.gov.al/wpcontent/uploads/2018/06/Strategjia\\_Kombetare\\_per\\_Punesim\\_dhe\\_Aftesi\\_Plani\\_Veprimi.pdf](http://financa.gov.al/wpcontent/uploads/2018/06/Strategjia_Kombetare_per_Punesim_dhe_Aftesi_Plani_Veprimi.pdf)

<sup>77</sup> Strategjia Kombëtare për Punësim dhe Aftësi 2014–2020.

<sup>78</sup> Qendrat Multifunksionale.

<sup>79</sup> Vendimin e Këshillit të Ministrave Nr.554, datë 31.07.2019 për krijimin, mënyrën e organizimit dhe të funksionimit të Agjencisë Kombëtare të Punësimin dhe Aftësive;

<sup>80</sup> European Commission. (2020). *Progress-Report for Albania 2020*, p.102.

Përkundër mundësisë për një integrim më të shpejtë në punësim për të diplomuarit e AFP si dhe përpjekjeve për promovim, regjistrimi në këto programe nuk po rritet. Profesionalizimi i mësuesve, hartimi i kurrikulës, menaxhimi i qendrës së AFP-së, përfshirja dhe sigurimi i cilësisë, janë elementë të cilët duhet të forcohen ndjeshëm në mënyrë që aspiratat e nxënësve dhe kërkesat e tyre të punës të adresohen siç duhet. Shqipëria është një anëtare aktive e Aleancës Evropiane për Praktikantët (EAfA)<sup>81</sup>, e cila synon të forcojë cilësinë, furnizimin dhe imazhin e praktikave në Evropë, dhe së fundmi lëvizshmërinë e praktikantëve. Vendi është i angazhuar të zbatojë dhe monitorojë Konkluzionet e Rigës 2015<sup>82</sup> mbi Arsimin dhe Trajnimin Profesional.

Megjithëse numri i studentëve të AFP me aftësi të kufizuara u rrit kohët e fundit, nevojiten më shumë përpjekje për të siguruar përfshirjen e popullatave në rrezik përjashtimi. Një grup pune u krijua për të hartuar një strategji për arsimin nga fëmijëria e hershme në arsimin e lartë për vitet e ardhshme dhe drafti i parë duhet të jetë gati në tremujorin e parë të 2021.

### ***Përfundime paraprake***

Në përfundim mund të themi se cilësia e edukimit në përgjithësi, si ai i përgjithshëm dhe ai profesional, në të gjithë vendin mbetet ende problematikë për shkak të pjesës së buxhetit të shtetit, që i jepet sistemit arsimor. Aksesit dhe gjithëpërfshirjes së nxënësve në sistemin arsimor, veçanërisht në zonat rurale mbetet ende problematikë<sup>83</sup>.

Bashkëpunimi mes aktorëve të sistemit arsimor, nxënësve dhe prindërve e bën të drejtën për arsim të pranueshëm<sup>84</sup>.

<sup>81</sup> Progress-Report for Albania 2020, p.103.

<sup>82</sup> Ibid.

<sup>83</sup> Ibid, p. 102-103.

<sup>84</sup> Miço, H. & Zaçellari, M. (2019). *Cituar më lart*, f. 95-96.

Kjo e drejtë dhe vetë sistemi arsimor kanë pësuar mjaft ndryshime pas viteve 1990, duke i dhënë kësaj të drejte kushtetuese një karakter demokratik dhe gjithëpërfshirës. Pavarësisht gjithë reformave dhe avancimit sistemi dhe përfituesit direkt të tij ndeshen me një sërë problematikash. Një pjesë e sfidave dhe problemeve të sistemit mund të adresohen me strategjinë e re për arsimin parauniversitar, që pritet të miratohet në 2021. Gjithsesi, analiza e kuadrit ligjor dhe politik tregon se janë bërë ndryshime cilësore për të përmirësuar sistemin, por këto reforma duhet të vazhdojnë dhe të thellohen më tej me qëllim garantimin në praktikë të së drejtës për arsim cilësor të të gjithë qytetarëve që jetojnë në Republikën e Shqipërisë.

## 1.5 E drejta për Arsim të Lartë

Arsimi i lartë në Shqipëri ka një histori relativisht të re krahasuar me vendet e konsoliduara Evropiane por edhe me disa vende fqinje në rajon. Pushtimi i gjatë Otoman, periudha e trazuar politike e pas-pavarësisë, pushtimet e njëpasnjëshme, prapambetja social-ekonomike dhe beteja e vazhdueshme e Shqipërisë se pas-1913 për mbijetesë e bëri praktikisht të pamundur krijimin e një sistemi të strukturuar të arsimit të detyrueshëm e aq me pak atij universitar. Në këtë mënyrë Shqipëria ka vuajtur në mënyrë kronike nga prapambetja dhe varfëria që pamundësonte një arsim të mirëfilltë dhe nga mungesa e arsimit e cila thellonte më tej prapambetjen dhe varfërinë strukturore të vendit.

Pas stabilizimit politik të vendit gjatë gjysmës së dytë të viteve 1920 dhe në vazhdim të viteve 1930 nën drejtimin e Ahmet Zogut në Shqipëri u strukturua një sistem deri diku efektiv i arsimit të detyrueshëm parauniversitar. Në mungesë të universiteteve dhe shkollave të larta, shteti ofronte një numër të vogël bursash universitare në universitetet Evropiane. Të

gjitha këto zhvillime së bashku përmirësuan gjendjen e arsimit në Shqipëri, por analfabetizmi mbeti i përhapur gjerësisht dhe strukturor ndërsa arsimi universitar mbetej ende një realitet i largët dhe i pamundur në një Shqipëri që ende mbetej feudale në shumë elementë.

Pushtimi Italian i vitit 1939 i ndjekur nga ai Gjerman i 1943 pas kapitullimit të Italisë, ndërpreu zhvillimet embrionike social ekonomike të reformave të Mbretit Zog me efekte negative edhe në ecurinë e arsimit. Lufta, mungesa e burimeve, pasiguria dhe mungesa e një autoriteti legjitim qeverisës e dobësoi edhe më tej sistemin arsimor shqiptar dhe e bëri edhe më të largët mundësinë e instalimit të një sistemi të strukturuar të arsimit të lartë.

Me vendosjen e regjimit komunist të Enver Hoxhës në 1944 u ndërmorën një sërë iniciativash në fushën e arsimit sidomos në lidhje me adresimin e analfabetizmit që ishte i përhapur në masë. Në vitin 1946 në Shqipëri mbi 82% e popullsisë ishte analfabete (Duro 2012: 17). Si rrjedhojë fokusi i politikave arsimore të pas-luftës ishte rivënia në jetë e shkollave filllore, zhvillimi i kurseve *ad-hoc* kundër analfabetizmit si dhe ‘trajtime’ të kondensuara pedagogjike për të certifikuar mësues për shkollat që do të hapeshin. Arsimi i lartë jo vetëm që mbetej ende i largët por ishte edhe praktikisht i pamundur në një vend me 82% analfabetizëm dhe mungesë të theksuar të instrumenteve pedagogjike dhe financiarë. *Duhet theksuar, ashtu siç do ta theksojmë vazhdimisht përgjatë kësaj përmbledhjeje analitike, se që nga fillimi regjimi komunist e pa sistemin e ri shkollor që po krijonte si instrument kyç për formimin politik të rinisë, strukturimin/institucionalizimin e dasive sociale në bazë të politikës dhe ndëshkimit të tyre që konsideroheshin si të padëshiruar duke i mohuar të drejtën për arsim ose duke i nën-shkolluar.*

Në ligjin e vitit 1946 mbi reformën arsimore në Shqipëri parashikoheshin struktura arsimore deri në arsimin e mesëm

bazë dhe jo më tej. Nga pikëpamja e aksesit në arsim, *garantimi me ligj i të drejtës për arsim dhe ofrimi i tij falas, zgjerimi aksesin për shumë fëmijë dhe qytetarë që më parë nuk e kishin pasur*. Gjithsesi ritheksojmë që ky arsim kishte një linjë të fortë politike dhe jo gjithmonë i ofrohej fëmijëve apo qytetarëve me prejardhje politike ‘të keqe’.

Nga pikëpamja strukturore, në vitin 1946 filloi puna për ngritjen e një *Instituti Pedagogjik 2-vjeçar*, drejtuar nga profesor Dhimitër Shuteriqi. Instituti, pavarësisht se nuk përmbushte kushtet e një institucioni të arsimit të lartë, duke qenë se kishte për synim të arsimonte mësues për sistemin e arsimit 7-vjeçar, mund të konsiderohet si embrioni pararendës i institucioneve të arsimit të lartë në Shqipëri. Pjesa kryesore e studentëve që ndiqnin institutin pedagogjik kishin bursa shtetërore dhe u punësuan në institucionet e reja të arsimit që po hapeshin në Shqipëri.

Ashtu siç kishte ndodhur edhe më parë gjatë viteve të monarkisë, edhe gjatë regjimit komunist, mungesa e një sistemi të mirëfilltë të arsimit universitar u kompensua me dërgimin e studentëve për arsim jashtë Shqipërisë. Ndryshe nga periudha e monarkisë, studentët u dërguan kryesisht në ish-BRSS dhe në vendet e ‘demokracive popullore’ nën sferën e influencës Sovjetike. Një nga kriteret kryesore të përzgjedhjes së bursantëve ishte kriteri politik ku preferoheshin studentë më prejardhje nga shtesa të varfra, fshatare dhe mbështetës të regjimit. *Personat me prejardhje nga familje kundërshtarë politike të regjimit nuk kishin akses në arsimin e lartë jashtë Shqipërisë dhe në bursat shtetërore*. Gjithsesi, nevoja e vendit për arsim të specializuar nuk mund të përmbushej nga studimet e disa studentëve jashtë vendit. Gjithashtu nevoja e regjimit komunist për të krijuar dhe zgjeruar shtresën e vet të ‘inteligjencës’ e bënte të domosdoshme ndërtimin e një sistemi më të strukturuar të arsimit të lartë.

Si rrjedhojë, në 1951 në Shqipëri u hapën 3 Institute të Larta: Pedagogjik, Politeknik, dhe Bujqësor me qëllim përgatitjen e specialistëve të nevojshëm për zhvillimin ekonomik të vendit. Edhe këto institute kishin një karakter të theksuar politik në programet e tyre duke i dhënë përparësi edukimit ideologjik të studentëve sipas parimeve të sanksionuara të Marksizëm-Leninizmit. Vlen të theksohet se hyrja në këto institute bazohej në provime që organizoheshin nga vetë instituti. Në 1952 u hapën edhe 2 institute të tjera: Instituti Ekonomik dhe Instituti Mjekësor. **Në vitin akademik 1952-1953, për herë të parë në Shqipëri kishte 530 studentë që ndiqnin këto institute.**<sup>85</sup> Zgjerimi i sistemit vazhdoi edhe në 1954 kur u hap edhe Instituti Juridik. Me konsolidimin dhe zgjerimin e këtyre instituteve, **në vitin akademik 1955-1956 në Shqipëri kishte 6 Institute me 22 fakultete dhe 1595 studentë.**<sup>86</sup> Pjesa dërrmuese e këtyre studentëve *mbështetej nga shteti me bursa të plota ose gjysmë bursa*. Kjo mbështetje kushtëzohej nga kushti politik ku preferoheshin *studentë me prejardhje fshatare ose të varfër të cilit nuk kishin 'probleme politike.'*

Në një farë mënyre, sistemi embrionik i arsimit të lartë në Shqipëri po përdorej për ndërtimin dhe strukturimin e një shtrese të re sociale, të indoktrinuar politikisht, ku do të mbështetej konsolidimi i mëtejshëm i regjimit komunist. Të gjithë të tjerët që shikoheshin me dyshim ose kishin 'probleme politike' pavarësisht aftësive, nuk pranoheshin në këto Institute.

Bazuar në institutet e krijuara si dhe duke parë ecurinë e punës, në 1957 - për herë të parë në Shqipërinë moderne - u hap Universiteti Shtetëror i Tiranës me 6 fakultete. Ky universitet kishte për qëllim që të vazhdonte dhe përmirësonte punën e Instituteve si dhe të thellonte objektivat e regjimit për specialistë më të mirë

<sup>85</sup> Duro, Ç. (2012). *Arsimi i Lartë në Shqipëri: 1946-1968* (punim doktorate), f. 53.

<sup>86</sup> *Ibid*, f. 56.

dhe të edukuar në frymën ideologjike të regjimit. Me kalimin e viteve sistemi i arsimit të lartë në Shqipëri erdhi duke u konsoliduar dhe zgjeruar duke hapur edhe një numër Institutesh Pedagogjike në disa qytete të rëndësishme të Shqipërisë. Gjithsesi, paralelisht me zgjerimin dhe konsolidimin e sistemit, u rrit dhe forcua kontrolli dhe karakteri ideologjik i tij. Pranimit në universitet bëheshin, përveç meritës, edhe mbi baza ideologjike dhe politike duke përjashtuar *a priori* një segment të konsiderueshëm të popullsisë. *Këto kufizime në akses krijuan një shtresë të tërë sociale ose të paarsimuar ose të nën-arsimuar duke thelluar dasitë dhe diferencimet strukturore sociale.* Struktura e arsimit në përgjithësi dhe e arsimit të lartë në veçanti u konsolidua nëpërmjet ligjit Nr. 4624 datë 24.12.1969 “Për sistemin e ri arsimor” i cili institucionalizoi më tej karakterin politik të arsimit në Shqipëri. Politizimi i arsimit të lartë arriti kulmin kur Universitetit Shtetëror të Tiranës iu ndërrua emërtimi në Universiteti “Enver Hoxha” pas vdekjes së diktatorit.

Situata vazhdoi e pandryshuar deri në rënien e regjimit komunist në 1991. Në fakt, pavarësisht përpjekjeve të vazhdueshme të regjimit komunist për ta pasur arsimin e lartë një burim mbështetje dhe legjitimiteti, *ishin pikërisht protestat studentore ato që shënuan fillimin e protestave masive kundër regjimit dhe përshpejtuan rënien e tij.* Ashtu si çdo sektor tjetër në Shqipëri në fillim të viteve 1990 edhe arsimit i lartë ishte në gjendje shume të vështirë financiare, infrastrukturore dhe tërësisht i ideologjizuar. Me vendosjen e pluralizmit filloi puna për reformimin e arsimit të lartë, modernizimin e programeve të studimit, kurrikulave, metodave të mësimdhënies si dhe hapjen procedurave të pranimit e mbështetjes financiare që kanë pasur një efekt domethënës në grupet që kanë pasur akses dhe mbështetje për të ndjekur studimet e larta. Në seksionet në vazhdim, do të paraqesim një përmbledhje analitike të ndryshimeve ligjore dhe strukturore në arsimin e lartë dhe efektin që kanë pasur ato në aksesin dhe të drejtën e të rinjve shqiptarë për t’u arsimuar.

### 1.5.1 Depolitizim apo Dekomunistizim?

Me rënien e regjimit komunist arsimit në përgjithësi dhe arsimit i lartë në veçanti filloi procesin e dekomunistizimit të programeve të studimit si dhe teksteve akademike ku glorifikoheshin roli udhëheqës i Enver Hoxhës dhe anatemohej sistemi kapitalist. Ky proces ishte i gjatë dhe i vështirë, por më i vështirë ishte ndryshimi i mentalitetit dhe praktikave në terren të cilat ishin rrënjësor nëpërmjet viteve të tëra praktike dhe indoktrinimi. Nga pikëpamja ligjore dhe strukturore, ligji i ri për arsimin e lartë numër 7810 u miratua në 1994. Ligji kishte për synim sanksionimin e praktikave të reja si dhe legjitimimin e një sërë universitetesh të reja në rrethe jashtë Tiranës. Gjithashtu ligji kishte për synim edhe përshtatjen e universiteteve ndaj realiteteve të reja ekonomike dhe politike me qëllim që ato të përgatisnin ekspertë për realitetin e ri shqiptar.

Ndryshe nga ligjet e mëparshme, *ligji i 1994 heq të gjitha referimet ndaj politizimit të arsimit të lartë, legjitimon lirinë akademike (neni 6), autonominë e universiteteve (neni 7) si dhe sanksionon konkursin publik si mënyra për të fituar të drejtën e studimit (neni 30)*. Studentëve i jepet e drejta për të patur organizata studentore jo-politike (neni 32) si dhe sanksionohet mbështetja financiare për studentët e shkëlqyer. Gjithsesi në një sërë nenesh i jepet mundësia ministrit përgjegjës për arsimin që të ndërhyjë në emërimet e drejtuesve të universiteteve duke vënë në pikëpyetje autonominë reale të tyre. Tradita etatiste bëri të mundur që as shteti dhe as vetë universitetet të mos ishin gati për një autonomi të thellë dhe reale.

Për sa i përket aksesit në arsim, elementi më i diskutueshëm i viteve të para të post-komunizmit kishte të bënte me listat e studentëve nga radhët e ish-të përndjekurve politikë të cilëve u jepej e drejta për studime universitare me vendime qeveritare thuajse jashtë sistemit të konkursit. Logjika, *a priori*, dukej e drejtë. Duke qenë që ajo shtresë e popullsisë ishte përjashtuar nga arsimit për dekada me radhë, diskriminimi pozitiv në



dukje ishte i arsyeshëm. Por me kalimin e viteve pati një sërë akuzash në media dhe pakënaqësi që këto lista po përdorshin për qëllime klienteliste dhe cilësia e studentëve ishte e ulët duke ndikuar negativisht në arsimin e lartë. Gjithashtu gjatë këtyre viteve u sanksionua edhe akses i veçantë (nëpërmjet kuotave të dedikuara) për komunitetet e marginalizuara në Shqipëri si dhe për diasporën, veçanërisht trojet e banuara nga shqiptarë në rajon. Pavarësisht se këto ishin zhvillime pozitive dhe të mirëpritura, dobësia ekonomike e shtetit shqiptar e vështirësonte shtrirjen e këtyre nismave përtej simbolikës.

Gjatë viteve 1990 krijimi i Universitetit Politeknik të Tiranës si dhe transformimi i Instituteve të Larta Pedagogjike të Elbasanit, Shkodrës, Vlorës, Korçës, dhe Gjirokastrës në universitete zgjeroi gamën e zgjedhjeve për studentët potencialë dhe rriti numrin e studentëve në arsimin e lartë. *Gjithsesi gjatë këtyre viteve një nga gangrenat kryesore të sistemit kishte të bënte me ndërhyrjet në provimet e pranimit që kishte efekt negativ për ato studentë që nuk kishin lidhjet e duhura.* Gjithashtu financimi i ulët i arsimit, për shkak të dobësisë dhe varfërisë së shtetit shqiptar, e bënte të vështirë për studentët që vinin nga shtesa të varfëra shoqërore apo që vinin nga zona të thella të Shqipërisë që të ndiqnin studimet e larta në Tiranë.

Së fundmi duhet përmendur që gjatë fillimit të viteve 1990 edhe pse pati një përpjekje të strukturuar për të dekomunistizuar universitetet shqiptare, *nuk pati një përpjekje po aq serioze për t'i depolitizuar ato.* Në shumë raste ka pasur akuza që thjesht u zëvendësua një kontroll politik me një tjetër. Kjo dukej, ndër të tjera, edhe nga fakti që disa rektorë të kësaj periudhe ishin edhe deputetë të parlamentit të rreshtuar me maxhorancën e kohës. Rreshtimet e hapura politike të drejtuesve të universiteteve mund të vinin në pyetje arsyetimin e vendimeve të tyre si dhe barazinë në akses apo efektin e politikës në akses. *Së fundmi, gjatë viteve 1990 shteti vazhdoi të mbante monopolin e arsimit të lartë në Shqipëri duke mos lejuar hapjen e institucioneve jo-publike.*

## 1.5.2 Konsolidim dhe autonomi e mëtejshme

Pas krizës së vitit 1997 dhe ndryshimit të qeverisë, në vitin 1999 u miratua ligji i ri për arsimin e lartë Nr. 8461. Ky ligj sanksionoi për herë të parë institucionet jo-publike të arsimit të lartë (neni 1) një risi e rëndësishme që kishte potencialin për të rritur gamën e ofertës akademike dhe zgjeruar aksesin në arsim për ato të cilët sektori publik nuk i përballonte ose ofronte shërbim. Gjithashtu ligji forcoi më shumë vetëqeverisjen e IAL-ve sidomos për sa i përket zgjedhjes së drejtuesve e cila gjithsesi ende bëhej nëpërmjet disa *praktikave të tërthorta e jo votimit të drejtpërdrejtë*.

Për sa i përket aksesit në arsim ligji nuk solli ndonjë risi që ia vlen të theksohet pasi ripërsëriti parimet e ligjit të pararendës. Në praktikë u rrallua, deri në eliminim, praktika e hyrjes në universitet me lista të veçanta e cila kishte sjellë pakënaqësi në vitet paraardhëse. Pranimi në universitete vazhdonte të ishte me konkurs të cilat vazhdonin të ishin problematike dhe shpesh kishte edhe akuza se ishin pre e ndërhyrjeve të jashtme dhe e praktikave korruptive. Ndërkohë aksesit për personat me aftësi të kufizuara gjatë gjithë kësaj periudhe nuk ka një trajtim të veçantë duke mos i dhënë rëndësi dhe si rrjedhojë infrastruktura fizike nuk mundësonte në thuajse asnjë institucion të arsimit të lartë aksesin për këtë grup.

Në tërësi, mund të thuhet që fundi i viteve 1990 dhe fillimi i viteve 2000 shënon një periudhë kur arsimi i lartë vijon konsolidimin, forcimin të autonomisë së cunguar të IAL-ve dhe zgjerimit të pjesëmarrjes në arsim. Problematike vazhdon të jetë aksesit për personat me aftësi të kufizuara fizike, për personat me pamundësi ekonomike dhe grupet e marginalizuara. Në tërësi arsimi i lartë gjatë kësaj periudhe vazhdon të mbetet një 'privilegj' i shtresës së mesme të qyteteve më të mëdha të Shqipërisë.

### 1.5.3 Liberalizim dhe zgjerim i arsimit të lartë

Në 2007, me ndryshimin e shumicës qeverisëse, u miratua përsëri një ligji i ri i arsimit të lartë Nr. 9741. Vetë shpeshësia e ndryshimit të ligjeve vështirësoi konsolidimin e praktikave të mira dhe është tregues i problematikave të qëndrueshme në këtë sektor. Në tërësi, ky ligj i dha një hapësirë më të madhe arsimit jopublik. P.sh. teksa ligji i 1999 thjesht e përmendte mundësinë e arsimit jo-publik, ligji i vitit 2007 i dedikon një nen të tërë me disa pika (neni 43). Kjo gjë bën që fundi i viteve 2000 të shoqërohet me një zgjerim eksponencial të IAL-ve jo-publike dhe të ofertës së tyre akademike për studentët. Ligji, gjithashtu ndryshe nga paraardhësi, e zgjeron autonominë e universiteteve duke sanksionuar votimin e drejtpërdrejtë të stafit akademik dhe studentëve për të zgjedhur organet drejtuese të universiteteve. Së fundmi, ligji mundëson edhe hapjen e filialeve të universiteteve në qytete me të vogla të vendit.

Në tërësi risitë dhe ndryshimet e ligjit Nr. 9741 për arsimin e lartë e rritën aksesin e të rinjve në arsimin e lartë. Hapja e IAL-ve jo-publike si dhe hapja e filialeve të IAL-ve publike në rrethe të izoluarra e rriti ndjeshëm numrin e studentëve në Shqipëri, mundësinë e zgjedhjes si dhe aksesin në arsim të lartë. Gjithsesi kjo hapje nuk u shoqërua me cilësinë e duhur akademike si dhe grupet që kishin qenë historikisht të marginalizuara vazhduan të mbeten të tilla pasi asnjë nga pengesat strukturore që ato kishin hasur ndër vite, nuk u adresua nga liberalizimi dhe zgjerimi i arsimit të lartë në Shqipëri.

Në fakt ky liberalizim rriti numrin e studentëve, numrin e diplomave, por jo domosdoshmërisht cilësinë e arsimit dhe të të diplomuarve. Aq problematike u bë situata sa që në 2014 qeveria i hoqi licencën e ushtrimit të aktivitetit 18 institucioneve jo-publike të arsimit të lartë. Njëkohësisht me këto nisma për kontrollin e ligjshmërisë dhe për rritjen e cilësisë në arsimin e lartë, qeveria filloi punën për hartimin e një ligji

të ri për arsimin e lartë i cili u miratua në fund të 2015. Ligji 80/2015 për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë është i katërti që pas rënies së komunizmit. Ligji kishte për synim saktësimin e procedurave dhe koncepteve si dhe përafrimin e sistemit të arsimit të lartë në Shqipëri me sistemin anglo-sakson. Gjatë gjithë periudhës së hartimit të ligjit si dhe pas aprovimit të tij ka pasur shumë debate publike sidomos për sa i përket aksesit në arsim reflektuar në tarifat studimore dhe bursat përkatëse. Që pas 2018 qeveria shqiptare ka marrë një sërë nismash për të ulur tarifat e studimit në IAL-të publike si dhe për të shtuar bursat për studentët e shkëlqyer dhe ato në nevojë.

#### 1.5.4 Konsolidim dhe 'shtrëngim'

Pas problemeve të identifikuara me cilësinë e shërbimit të ofruar nga IAL-të gjatë viteve 2000 si dhe pas mbylljes së një numri të lartë IAL në 2014, u miratua ligji i ri i arsimit të lartë. Aktualisht, bazuar në ligjin 80/2015 "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë" dhe aktet nënligjore pasuese, institucionet e Arsimit të Lartë kategorizohen në institucione publike dhe jopublike. Institucioni kryesor i ngarkuar me formulimin dhe zbatimin e politikës shtetërore mbi arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor është Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë (MASR). IAL-të publike financohen nga buxheti i shtetit, të ardhurat e tyre përmes tarifave të studentëve dhe / ose burimeve të tjera ligjore. Nga ana tjetër, IAL-të jopublike mund të kryejnë veprimtari fitimprurëse ose jofitimprurëse dhe burimi i tyre më i madh i financimit janë tarifat e shkollimit të studentëve.

Aktualisht, në Republikën e Shqipërisë, ushtrojnë aktivitetin 41 institucione të arsimit të lartë që ofrojnë diploma të programeve të studimit për studentë shqiptarë dhe ndërkom-bëtarë. Institucionet e arsimit të lartë dallohen nga struktura e

tyre organizative që, bazuar në Ligjin 80/2015, përcakton kategorizimin e tyre si më poshtë:

- ❖ **Universiteti:** (duhet të ketë të paktën 3 fakultete): aktualisht ka 21 universitete, nga të cilat 12 publike dhe 9 jopublike:

Institucionet e tipit universitar përbëhen nga të paktën tre njësi të tipit të fakultetit. Njësi të tjera kryesore, të krahasueshme me fakultete, mund të jenë institucione kërkimore ose kolegje të larta profesionale. Aktualisht, shumica e universiteteve, me përjashtim të fakulteteve, kanë krijuar institucione kërkimore-shkencore. Ndërsa Universiteti i Mjekësisë i Tiranës përfshin strukturat shëndetësore universitare në Qendrën Spitalore Universitare Nënë Tereza. Institucionet e tipit universitar ofrojnë programe studimi në të gjitha ciklet e studimeve të arsimit të lartë (nga bachelor në doktoraturë) si dhe programe studimi profesionale që nuk klasifikohen si studime universitare.

- ❖ **Kolegji Universitar** (duhet të ketë të paktën 2 fakultete): aktualisht ka 20 kolegje universitare, të gjitha jopublike:

Institucionet e tipit të Kolegjit Universitar përbëhen nga të paktën dy fakultete. Shumica e Kolegjeve Universitare janë të organizuara në dy fakultete, ndërsa vetëm dy prej tyre kanë tre fakultete dhe dy të tjerë kanë si njësi të tretë kryesore një kolegji të lartë profesional. Kolegjet universitare ofrojnë programe studimi të ciklit të parë dhe të dytë (bachelor dhe master) ndërsa 5 prej tyre gjithashtu ofrojnë programe studimi profesional.

- ❖ **Akademia** (duhet të ketë të paktën 1 fakultet): Aktualisht ka 5 akademi, nga të cilat 3 publike dhe 2 jo-publike.

Institucionet e tipit të akademisë përbëhen nga të paktën një fakultet dhe gjithashtu mund të përfshijnë një kolegji të lartë profesional. Për më tepër, akademitë, sipas specifikës dhe fushës së tyre të kompetencës, mund të ofrojnë programe studimi në të tre ciklet. Deri më tani, vetëm dy akademi publike ofrojnë programe studimi të ciklit të tretë. Aktualisht, një IAL jo-publike ofron programe studimi në fushën e kinematografisë dhe gëzon një status të veçantë. Statusi i veçantë jepet me vendim të Këshillit të Ministrave me propozim të Ministrisë së Arsimit për IAL-të që ofrojnë programe studimi në fusha të veprimtarisë akademike specifike, në lidhje me organizimin dhe zhvillimin e procesit mësimor.

- ❖ **Kolegji i Lartë Profesional** (duhet të ketë të paktën 2 departamente): aktualisht ka 2 Kolegje të Larta Jo-publike Profesionale.

Institucionet e tipit të Kolegjit të Lartë Profesional ofrojnë veprimtari profesionale të mësimdhënies dhe trajnimit që zgjasin 1 ose 2 vite akademike, përkatësisht 60 ECTS ose 120 ECTS.

Nga 41 IAL që veprojnë në Shqipëri, 32 ndodhen në Tiranë. Prej tyre 9 janë institucione publike të arsimit të lartë (3 Akademi dhe 6 Universitete). 23 të tjerët janë institucione të arsimit të lartë jo-publik të kategorizuar si më poshtë: 10 Universitete, 8 Kolegje Universitare, 2 Akademi, 2 Kolegje të Larta Profesionale dhe 1 Arsim i Lartë Universitar. Jashtë Tiranës, ka edhe 3 institucione të arsimit të lartë jopublik të vendosur në Vlorë dhe Progradec. Gjithashtu, jashtë Tiranës ka 6 universitete publike të vendosura në qytetet e mëposhtme: Shkodër, Durrës, Elbasan, Vlorë, Korçë dhe Gjirokastrë. Në shumicën e institucioneve të arsimit të lartë, njësitë kryesore të Fakultetit dhe Institutit të Kërkimeve përbëhen nga tre ose më shumë departamente ose dy ose më shumë departamente dhe një qendër kërkimore. Departamentet dhe qendrat kërkimore janë njësitë bazë të një institucioni të arsimit të lartë, të cilat

janë përgjegjëse për programet e studimit që ato ofrojnë dhe janë në varësi të njësive kryesore: fakulteteve ose instituteve kërkimore.

Së fundmi, sipas ligjit të arsimit të lartë 80/2015, programet e studimit në Shqipëri janë të organizuara në cikle sipas Kartës së Bolonjës. Institucionet e tipit universitar mund të ofrojnë ciklin e parë të studimeve (bachelor), ciklin e dytë (master) dhe ciklin e tretë të studimeve (doktoratë, specializime afatgjata si dhe master ekzekutiv) ndërsa institucionet e tipit kolegji universitar mund të ofrojnë vetëm dy ciklet e para. Programet Bachelor janë të organizuara në 3 vite akademike me gjithsej 180 ECTS. Programet e ciklit të dytë organizohen në 1 vit akademik / 60 ECTS (Master Profesional), 2 vite akademike 120 ECTS (Master Profesional, Master i Shkencave dhe Master i Arteve), ose 5 vite akademike / 300 ECTS (program i integruar) i cili përfshin të dy ciklet. Programet e ciklit të tretë përfshijnë studime afatgjata të specializimit të organizuara në 3 vite akademike / 180 ECTS ose 5 vjet / 300 ECTS, “Master Ekzekutiv” të organizuar në 1 vit akademik / 60 ECTS ose 2 vite akademike 120 ECTS dhe studime të doktoratës të cilat zgjasin të paktën 3 vite akademike. Aksesi në këto programe varet nga përmbushja e kriterëve akademike (mesatarja dhe diplomimi i ciklit paraardhës).

### **1.5.5 Përfundime paraprake - Shumë përparime dhe shumë punë për të bërë**

Siç u vu re edhe nga kjo përmbledhje analitike, sistemi i arsimit të lartë në Shqipëri ka një histori të re dhe një strukturë të brishtë duke reflektuar dhe përforcuar njëkohësisht problematikat sociale dhe ekonomike të Shqipërisë. Duke filluar nga Instituti Pedagogjik 2-vjeçar i 1946-tës e deri më sot natyrisht që Shqipëria ka bërë shumë hapa para, por tekta Shqipëria ka përparuar ashtu ka bërë edhe pjesa tjetër e botës e cila ka një sistem shumë më të vjetër e të konsoliduar. Kë-

sisoj për Shqipërinë nuk është mjaftueshëm që të ecë përpara e të përparojë, ajo duhet të ecë përpara më shpejt se të tjerët që i ka si referencë, për të kapur kohën e humbur e për të rekuperuar distancë që e ndan nga vendet me të cilat krahasohet.

Edhe nga pikëpamja e aksesit në arsimin e lartë Shqipëria ka përparuar në mënyrë domethënëse. Deri në 1957 Shqipëria nuk kishte institucione të mirëfillta të arsimit të lartë, ndër-  
sa sot ka 41. Vetëm nga ky këndvështrim aksesit në arsim është shumëfishuar. Gjithashtu, dhe po aq e rëndësishme, sot e drejta për arsim nuk kushtëzohet nga orientimi politik apo përkatësia politike familjare. Gjithsesi, edhe pse diskriminimet e hapura dhe ligjore që ekzistonin nuk janë më, një sërë diskriminimesh, më të fshehura, por po aq problematike, vazhdojnë. Studentët potencialë nga komunitetet e marginalizuara, personat me aftësi të kufizuara si dhe ato që vijnë nga grupe social-ekonomike të varfra e të izoluara përballen me pengesa të qenësishme për të pasur akses në arsimin e lartë. Vënia në zbatim e programeve të ‘targetuara’ për të adresuar vështirësitë e tyre nuk do të jetë e lehtë as strukturalisht dhe as financiarisht, por është e rëndësishme në rrugën e konsolidimit dhe zgjerimit të aksesit në arsimin e lartë në Shqipëri.





## E DREJTA PËR ARSIM SI E DREJTË THEMELORE NË TË DREJTËN NDËRKOMBËTARE

Garantimi i të drejtave dhe lirive themelore të njeriut përmes akteve dhe të drejtës ndërkombëtare lindi si domosdoshmëri pas Luftës së Dytë Botërore, ku u pa nevoja për mbrojtjen e individit nga shteti brenda juridiksionit të të cilit ai jeton. Ndërkohë, në referimin e saj klasik e drejta ndërkombëtare rregullon marrëdhëniet mes shteteve dhe respekton parimin e reciprocitetit<sup>1</sup>. Natyrisht që miratimi i akteve ndërkombëtare në këtë fushë është marrja e masave për të parandaluar shkeljen e të drejtave dhe lirive themelore<sup>2</sup>. Kryesisht të drejtat dhe liritë themelore janë të një karakteri politik dhe civil, në një kohë kur pjesa tjetër e të drejtave, që në një pjesë të madhe të familjeve juridike konsiderohen të drejta kushtetuese, përfshihen nën kategorinë e të drejtave sociale dhe ekonomike. Një rast përjashtimor në lidhje me këtë kategorizim bën e drejta për arsim, e drejta e pronës dhe barazia mes bashkëshortëve të drejta këto të mbrojtura drejtpërdrejtë në një pjesë të konventave ndërkombëtare<sup>3</sup>. Kjo e drejtë luan një rol thelbësor në mbështetje të zbatimit të të drejtave të tjera themelore<sup>4</sup>.

<sup>1</sup> Peçl, I. & Xhepa, I. (2019). E drejta për mbrojtjen nga diskriminimi: manual. Tiranë: f. 60.

<sup>2</sup> Noëak, M. (2003). Introduction to the international human rights regime. Leiden: Brill academic publishers, p. 27.

<sup>3</sup> Mole, N. & Kamber, K. & Liaki, V. (2018). Cituar më lartë, f. 10.

<sup>4</sup> European Court of Human Rights. (2020). Guide on Article 2 of Protocol no. 1 to the European Convention on Human Rights, p. 6.

Në vazhdim do të paraqesim një panoramë të përgjithshme mbi mbrojtjen dhe garantimin në nivel ndërkombëtar të të drejtës për arsim si e drejtë themelore, duke i ndarë këto garanci sipas karakterit ndërkombëtar të përgjithshëm dhe ndërkombëtar rajonal.

## 2.1 Akte Ndërkombëtare të miratuara nga Organizata e Kombeve të Bashkuara

Akti i parë ndërkombëtar, që garantoj një katalog të gjerë lirisht dhe të drejtash si themelore është Deklarata Universale për të Drejtat e Njeriut (DUDNj - 1948)<sup>5</sup>, e cila cilësohet si baza për të gjithë konventat dhe paktet e mëvonshme. Neni 26 i DUDNj-së sanksionon të drejtën e gjithsecilit për arsimim:

1. Gjithsecili ka të drejtën për arsimim. Arsimimi duhet të jetë falas, të paktën në ciklin e ulët dhe të mesëm. Cikli i ulët duhet të jetë i detyrueshëm. Arsimi teknik dhe profesional duhet të ofrohet për të gjithë, ndërkohë që arsimi i lartë duhet të jetë i aksesueshëm për të gjithë mbi bazë merite.
2. Edukimi duhet të ketë në vëmendje zhvillimin tërësor të personalitetit njerëzor dhe të forcojë respektimin e të drejtave dhe lirive themelore të njeriut. Ai duhet të promovojë mirëkuptimin, tolerancën dhe miqësinë mes shteteve, racave ose grupeve fetare dhe të vazhdojë aktivitetin e Kombeve të Bashkuara për paqe.
3. Prindërit kanë të drejtë të zgjedhin llojin e edukimit, që do të marrin fëmijët e tyre.

---

<sup>5</sup> Deklarata Universale e të Drejtave të Njeriut, mbledhja plenare e 138 e Asamblesë së Kombeve të Bashkuara 10.12.1948.

Megjithëse, DUDNj mbeti vetëm një akt ndërkombëtar me karakter deklarativ, ajo frymëzoi hartimin dhe miratimin e një sërë aktesh të tjera që përfshijnë dhe garantimin e të drejtës për arsimim.

Një akt tjetër në mbrojtje të së drejtës për arsimim/të drejtës së edukimit është Konventa Kundër Diskriminimit në Arsim miratuar në 1960<sup>6</sup> (Konventa e UNESCO-s), e ratifikuar edhe nga Shqipëria. Kjo Konventë mbron të gjithë qytetarët e shteteve palë nga diskriminimi në arsim për çdo lloj shkak. Gjithash-tu, ajo i kërkon shteteve të ndërmarrin masa për të formuluar, zhvilluar dhe zbatuar politika kombëtare të cilat promovojnë trajtimin e barabartë në çështje, që lidhen me edukimin. Monitorimi i Konventës bëhet nga Bordi Ekzekutiv. Me qëllim monitorimin periodik dhe zbatimin efektiv të saj, Bordi vendosi të miratojë një procedurë specifike disa shkallëshe<sup>7</sup>.

Pakti Ndërkombëtar mbi të Drejtat Civile dhe Politike (1966)<sup>8</sup> përfshin në parashikimet e tij mbrojtje për të drejtën e qytetarëve për t'u arsimuar. Konkretisht në nenin 18 të tij Pakti kërkon agazhimin e shteteve palë për të lejuar prindërit të edukojnë fëmijët e tyre sipas bindjeve personale.

*Neni 18*

*[...]*

*4. Shtetet palë të këtij Pakti zotohen të respektojnë lirinë e prindërve dhe, kur është e zbatueshme, të kujdestarëve të ligjshëm për të siguruar edukimin fetar dhe moral të fëmijëve të tyre në përputhje me bindjet e tyre.*

*Mekanizmat monitorues të Paktit, të cilat garantojnë zbatimin e të drejtave të parashikuara në të, janë: a)*

<sup>6</sup> Konventa Kundër Diskriminimit në Arsim datë 14.12.1960.

<sup>7</sup> [http://portal.unesco.org/en/ev.php-URL\\_IDç27968&URL\\_DOçDO\\_TOPIC&URL\\_SECTIONç201.html](http://portal.unesco.org/en/ev.php-URL_IDç27968&URL_DOçDO_TOPIC&URL_SECTIONç201.html) [konsultuar më 12.10.2020].

<sup>8</sup> Pakti Ndërkombëtar mbi të Drejtat Civile dhe Politike datë 16.12.1966.

*raportet e detyrueshme vjetore që duhen përgatitur nga shtetet palë pranë Komitetit të të Drejtave të Njeriut; b) hetimet potenciale mbi ankimet e individëve.*

Pakti Ndërkombëtar për të Drejtat Ekonomike, Sociale dhe Kulturore (1969)<sup>9</sup> e cilëson të drejtën e arsimit si të drejtë universale. Kjo natyrë i vishet kësaj të drejte, sipas parashikimeve të nenit 13 të Paktit, pasi ajo shtrin garancinë për çdo individ pavarësisht nga mosha, gjuha, origjina ose status tjetër.

### *Neni 13*

- “1. Shtetet palë të këtij Pakti, njohin të drejtën e secilit për arsim. Ato pajtohen se arsimi duhet të orientohej drejt zhvillimit të plotë të personalitetit njerëzor dhe të ndjenjës së dinjitetit të tij dhe të forcojë respektin për të drejtat dhe liritë themelore të njeriut. Ato pastaj pajtohen se arsimi duhet t'i mundësojë secilit për të marrë pjesë në mënyrë efektive në një shoqëri të lirë, të ndihmojë mirëkuptimin, tolerancën dhe miqësinë midis të gjitha kombeve dhe të gjitha grupeve racore, etnike ose fetare dhe zhvillimin e veprimtarive të Kombeve të Bashkuara për ruajtjen e paqes.*
- 2. Shtetet palë të këtij Pakti pranojnë se për të arritur realizimin e plotë të kësaj të drejte: (a) Arsimi fillor duhet të jetë i detyrueshëm dhe falas për të gjithë.*
- (b) Arsimi i mesëm, në format e tij të ndryshme, duke përfshirë arsimin e mesëm teknik dhe profesional, duhet të jetë në dispozicion në mënyrë të përgjithshme dhe i hapur për të gjithë me të gjitha mjetet e përshtatshme sidomos me vendosjen progresive të ndjekjes së mësimin falas;*

---

<sup>9</sup> Pakti Ndërkombëtar për të Drejtat Ekonomike, Sociale dhe Kulturore datë 16.12.1969.

- (c) *Arsimi i lartë duhet të bëhet i hapur për të gjithë në mënyrë të barabartë sipas aftësive të secilit, me të gjitha mjetet e përshtatshme e sidomos me vendosjen progresive të ndjekjes së mësimi falas;*
  - (d) *Arsimi themelor duhet të inkurajohet ose të intensifikohet, mundësisht sa më shumë, për ata persona të cilët nuk kanë pasur ose nuk kanë përfunduar plotësisht tërë periudhën e arsimit të tyre fillor;*
  - (e) *Duhet të vazhdohet aktivisht zhvillimi i një rrjeti shkollor në të gjitha shkallët, të vendoset një sistem i përshtatshëm bursash dhe të përmirësohen vazhdimisht kushtet materiale të personelit mësimor.*
3. *Shtetet palë të këtij Pakti zotohen të respektojnë lirinë e prindërve dhe, po qe se është e nevojshme, të kujdestarëve ligjorë, për të zgjedhur për fëmijët e vet shkollat, përveç atyre që i kanë themeluar autoritetet publike, por që të jenë në përputhje me normat minimale që mund të jenë caktuar ose miratuar nga shteti në fushën e arsimit, dhe për të siguruar arsimimin fetar dhe moral të fëmijëve të tyre në përputhje me bindjet e tyre.*
4. *Asnjë pjesë e këtij neni nuk duhet të interpretohet si ndërhyrje në lirinë e individëve dhe të personave juridikë për të krijuar dhe drejtuar institucione arsimore, por gjithnjë me kusht që parimet e shpallura në paragrafin 1 të këtij neni të respektohen dhe që arsimi i dhënë në institucionet e tilla të jetë në përputhje me normat minimale që mund të jenë caktuar nga shteti.”*

Pranimi universal i të drejtës për arsimim edukimit i përgjigjet pyetjes nëse vlera e kësaj të drejte pranohet nga të gjitha komunitetet, si ato politike, sociale, fetare apo kulturore<sup>10</sup>. Në bazë të nenit 13 të Paktit, shtetet angazhohen të marrin masa

---

<sup>10</sup> Miço, H. (2019). *Cituar më lart*, f. 46-47.

të përcaktuara në plane veprimi të hollësishme për zbatimin progresiv të të drejtës së edukimit. Megjithatë shumë shtete kanë dështuar në përmbushjen e detyrimit të ofrimit të arsimit apo në realizimin e të drejtës<sup>11</sup>.

Konventa Ndërkombëtare Për Eliminimin e të Gjitha Formave të Diskriminimit Racor (1965)<sup>12</sup> parashikon në dispozitat e saj edhe një mbrojtje për të drejtën për arsim. Konkretisht në nenin 2 (2) parashikon marrjen e masave specifike në fushat socio-ekonomike, kulturore etj. për mbrojtjen nga diskriminimi dhe garantimin e gëzimit të plotë të të drejtave të njeriut.

### *Neni 2*

*[...]*

*2. Shtetet palë, po qe se e kërkojnë rrethanat, do të marrin masa të posaçme dhe konkrete në fushën sociale, ekonomike, kulturore dhe në fusha të tjera, për të siguruar zhvillimin dhe mbrojtjen adekuate të disa grupeve racore apo individëve që bëjnë pjesë në këto grupe me qëllim që t'u garantojnë atyre gëzimin e plotë dhe të barabartë të të drejtave dhe të lirive themelore të njeriut. Këto masa kurrsesi nuk duhet të kenë për pasojë ruajtjen e të drejtave të pabarabarta apo të veçanta për grupet e ndryshme racore pasi të jenë arritur objektivat që ato i kanë synuar.*

Sikurse në rastin e traktateve të mëparshme mekanizmi monitorues i kësaj Konvente është Komiteti për Eliminimin e të Gjitha Formave të Diskriminimit Racor, që përbëhet nga 18 ekspertë. Ndërkohë, që shtetet palë kanë detyrim të paraqesin raporte periodike për respektimin e këtyre garancive.

---

<sup>11</sup> Ibid, f. 47.

<sup>12</sup> Konventa Ndërkombëtare Për Eliminimin e të Gjitha Formave të Diskriminimit Racor datë 18.12.1979.

Konventa mbi Eliminimin e të Gjitha Formave të Diskriminimit ndaj Grave (1979)<sup>13</sup> ose konventa CEDAW garanton barazinë gjinore në shoqëri për të gjithë shtetet palë të saj. Pavarësisht datës së hershme të miratimit të saj, kjo Konventë ka marrë tepër relevancë në dekadat e fundit, pasi është vërejtur mos evoluimi i shoqërisë sa i takon barazisë gjinore. Konventa CEDAW parashikon garanci për të drejta të barabarta të grave dhe vajzave në fushën e arsimit, duke shmangur çdo lloj diskriminimi potencial.

#### *Neni 10*

*Shtetet palë do të marrin të gjitha masat e përshtatshme për të eliminuar diskriminimin ndaj grave, me qëllim që t'u sigurohen atyre të drejta të barabarta me burrat në fushën e arsimit, në mënyrë të veçantë, për të siguruar mbi bazën e barazisë midis burrave dhe grave: [...]*

Rëndësi e veçantë i jepet garancive në sigurimin e të drejtës për arsimim në zonat rurale për të gjitha nivelet e arsimit, si dhe mundësia e ndjekjes së programeve të njëjta mes grave/vajzave dhe burrave/djemve.

Konventa për Mbrojtjen e të Drejtave të Fëmijëve (1989)<sup>14</sup> është një ndër aktet më të rëndësishme në nivel ndërkombëtar që mbron dhe garanton respektimin në praktikë të të drejtave të fëmijës. Një e drejtë tepër e rëndësishme në këtë kuadër është dhe mbrojtja dhe garancitë në fushën e arsimit, edukimi në përputhje me filozofinë e prindërve dhe mbrojtja nga diskriminimi në këtë kuadër. Rëndësia e shtuar në këtë rast është kategoria e personave, që mbron kjo Konventë, pikërisht fëmijët, të cilët janë një grup tepër vulnerabel i shoqërisë. Konventa i kërkon shteteve të marrim të gjitha e nevojshme dhe përshtatshme për garantimin e këtyre të drejtave.

<sup>13</sup> Konventa mbi Eliminimin e të Gjitha Formave të Diskriminimit Ndaj Grave datë 18.12.1979.

<sup>14</sup> Konventa për të Drejtat e Fëmijës datë 20.11.1989.

Zbatimi i Konventës monitorohet nga Komiteti i të Drejtave të Fëmijëve përbërë nga 18 ekspertë.

#### *Neni 28*

- 1. Shtetet Palë njohin të drejtën e fëmijës për arsimim dhe, me qëllim që të arrihet kjo e drejtë, hap pas hapi dhe mbi bazën e mundësive të barabarta, në mënyrë të veçantë ata: [...]*
- 2. Shtetet Palë marrin të gjitha masat e nevojshme për të siguruar që disiplina shkollore të zbatohet në mënyrë të pajtueshme me dinjitetin njerëzor të fëmijës dhe në përputhje me këtë Konventë.*
- 3. Shtetet Palë nxisin dhe inkurajojnë bashkëpunimin ndërkombëtar në fushën e arsimit, për të kontribuar, në mënyrë të veçantë, në zhdukjen e padijes dhe të analfabetizmit kudo në botë dhe për të lehtësuar përvetësimin e njohurive shkencore e teknike dhe të metodave moderne të mësimdhënies. Për këtë, mbahen parasysh në mënyrë të veçantë nevojat e vendeve në zhvillim.*

Respektimi rigoroz i Konventës është sfidues për secilin vend anëtar në kuadër të vendosjes në prioritet të interesit më të lartë të fëmijës.

Konventa e OKB-së për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara (2006)<sup>15</sup> është një ndër aktet më të reja ndërkombëtare, që garanton mbrojtjen e një kategorie vulnerabël të anëtarëve të shoqërisë, pikërisht personave me aftësi të kufizuara. Kështu, kjo Konventë parashikon në disa nene të saj të drejtën e personave me aftësi të kufizuara për të aksesuar sistemin arsimor dhe ndërmarrjen e përshtatjes së arsyeshme për të zbatuar efektivisht të drejtat e tyre.

---

<sup>15</sup> Konventa për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara datë 13.12.2006



## 2.2. Aktet Ndërkombëtare me Karakter Rajonal - Këshilli i Evropës

Garantimi i të drejtës për arsim në Evropë kryhet përmes një sërë instrumentesh të miratuara nga Këshilli i Evropës dhe Bashkimi Evropian. Meqenëse ky manual synon një audiencë shqiptare, jo domosdoshmërisht njohëse të thelluar të ligjit dhe së drejtës, për qëllime të këtij materiali do të thellohem në Konventat e miratuara nga Këshilli i Evropës, organizatë ndërkombëtare pjesë e së cilës është dhe Shqipëria prej 2 korrikut 1995.

Këshilli i Evropës është një organizatë ndërkombëtare rajonale e themeluar pas Luftës së Dytë Botërore, për të garantuar të drejtat dhe liritë themelore të individëve, që jetojnë në Evropë. Sot Këshilli numëron 47 shtete anëtare dhe është i vetmi institucion ndërkombëtar, që mbron të drejtat e njeriut në të cilin Federata Ruse bën pjesë<sup>16</sup>. Akti më i rëndësishëm i miratuar nga organizata është Konventa Evropiane për të Drejtat e Njeriut (KEDNJ). Konventa u konceptua si përgjigje ndaj ngjarjeve të ndodhura në Luftën e Dytë dhe siguron një kornizë bazë për mbrojtjen e të drejtave dhe lirive themelore në nivel ndërkombëtar. Risi e Konventës në nivel ndërkombëtar është roli aktiv i individëve, i cili deri përpara miratimit të saj ishte jo ekzistent, për të kërkuar mbrojtje të të drejtave dhe lirive të tyre pas shterimit të të gjitha mjeteve ligjore vendase<sup>17</sup>.

### 2.1.1. Konventa Evropiane për të Drejtat e Njeriut

Katalogu i të drejtave të mbrojtura nga Konventa përfshin kryesisht të drejta civile dhe politike. Përjashtim është bërë për disa të drejta të karakterit socio-ekonomik që konsiderohen thelbësore për ekzistencën e njeriut, të cilat iu shtuan

---

<sup>16</sup> <https://www.coe.int/en/web/portal/47-members-states> [konsultuar më 13.10.2020].

<sup>17</sup> Mole, N. et.al *Cituar më lart*, f. 9.

tekstit origjinal të Konventës me Protokollin nr. 1<sup>18</sup>. Në këto të drejta përfshihet dhe e drejta për arsim.

*Neni 2 i Protokollit nr. 1*

*Askujt nuk mund t'i mohohet e drejta për arsimim. Shteti, në ushtrimin e funksioneve që merr përsipër në fushën e edukimit dhe të arsimit, respekton të drejtën e prindërve për të siguruar këtë edukim dhe arsim në përputhje me bindjet e tyre fetare dhe filozofike.*

E drejta për arsim bën pjesë në kategorinë e të drejtave “të tjera” të mbrojtura nga Konventa, për kufizimin e të cilave shtetet palë duhet të krijojnë sisteme rregullatore për zbatimin efektiv dhe gëzojnë një hapësirë më të gjerë vlerësimi për kufizimin e tyre<sup>19</sup>.

Fjalja e parë e nenit 2 u ofron individëve, që jetojnë brenda juridiksionit të Konventës, të drejtë për akses efektive në institucionet arsimore që ekzistojnë, por nuk detyron shtetin të krijojë institucione të reja. Ndërkohë, fjalia e dytë lejon prindërit të edukojnë fëmijët e tyre sipas bindjeve të tyre politike dhe fetare. Neni 2 i Protokollit nr. 1 shtrin garancitë për të gjithë nivelet e arsimit, fillor, të mesëm dhe të lartë, të zakonshëm dhe profesional. Konventa kërkon përgjegjësinë e shteteve palë për institucionet publike dhe private të arsimit, duke mos lejuar delegimin e kësaj përgjegjësie<sup>20</sup>. Ky nen nuk përmban një listë shteruese të kufizimeve të lejuara, për të cilat shteti legjitimohet, por lejon sikurse përmendëm dhe më lartë

<sup>18</sup> Protokoll shtesë i Konventës për Mbrojtjen e të Drejtave dhe të Lirive Themelore, 20.3.1952.

<sup>19</sup> European Court of Human Rights. *Cituar më lart*, p. 6. Shih dhe çështjet: *Golder k. Mbretërisë së Bashkuar*, vendim i 21 shkurtit 1975, nr. 4451/70 paragrafi 38 dhe *çështja Gjuhësore Belge*, vendim i 23 korrikut 1968, nr. 1474/62, 1677/62, 1691/62, 1769/63, 1994/63 dhe 2126/64, paragrafi 5.

<sup>20</sup> Bianku, L. & Mole, N. & Smith, H. (2020). *Covid-19 dhe impakti mbi të drejtat e njeriut: shikim i përgjithshëm mbi jurisprudencën përkatëse të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut*, f. 120 dhe gjithë vendimet e cituara në footnote 377-379.

një hapësirë më të gjerë vlerësimi në diskrecion të shtetit. Megjithatë, kufizimet e të drejtës për arsim, ashtu sikurse dhe të gjithë të drejtave të tjera themelore, duhet të jetë i parashikueshëm, i ndjekur nga një qëllim legjitim dhe ndërhyrja duhet të jetë proporcionale me qëllimin e synuar<sup>21</sup>.

Konventa garanton veçanërisht mbrojtjen nga diskriminimi në arsim, duke e lexuar nenin 2 të Protokollit nr. 1 së bashku me nenin 14 të Konventës dhe Protokollin nr. 12, krijon detyrime pozitive për shtetin<sup>22</sup>. Kështu arsimi duhet të jetë gjithëpërfshirës dhe të adresojë në mënyrë të veçantë nevojat e nxënësve me aftësi të kufizuara<sup>23</sup>. Përpos situatave të trajtuara nga Gjykata e Strasburgut, një situatë ku një pjesë e madhe e përfituesve të arsimit mund të ngrenë pretendime mbi diskriminim potencial për shkak të mungesës së mundësisë për të ndjekur arsimin është dhe rasti i ndërprerjes së procesit mësimor për shkak të pandemisë Covid-19, ku sfidë e përbashkët e të gjithë qeverive ishte garantimi i qasjes së barabartë në arsim<sup>24</sup>.

Në përgjigje të nevojës për të ndalur përhapjen e virusit mbyllja e shkollave detyroi institucionet arsimore të ofronin programimin mësimor *online*, realitet i cili nuk ishte i aksesueshëm për të gjithë, veçanërisht për nxënësit me probleme social-ekonomike, ose me aftësi të kufizuara. Shtetet u munduan të adresonin këto probleme duke mundësuar ofrimin e programit mësimor jo vetëm në platformat digjitale, por dhe në televizionet publike, duke zvogëluar kështu mungesën e barazisë në aksesin në arsim mes nxënësve të niveleve të ndryshme ekonomike. Këto masa tregojnë, që shtetet i kanë kushtuar rëndësi pasojave, që shkaktoi situata për personat më vulnerabël të shoqërisë duke iu përgjigjur këtyre nevojave në kohë<sup>25</sup>.

<sup>21</sup> *Layla Şhain k. Turqisë*, vendim i Dhomës së Madhe i 10 nëntorit 2005, nr. 44774/98.

<sup>22</sup> Mole, N. & Kamber, K. & Liaki, V. *Cituar më lart*, f. 26.

<sup>23</sup> Bianku, L. & Mole, N. & Smith, H. *Cituar më lart*, f. 122.

<sup>24</sup> *Ibid*, f. 123.

<sup>25</sup> *Ibid*, f. 123-125.

Për qëllime të këtij botimi është përgatitur dhe një përmbledhje e shkurtër e disa prej vendimeve më të rëndësishme dhënë nga GjEDNJ në lidhje me garantimin e të drejtës për arsimim.

### 2.1.2. Karta Sociale Evropiane dhe instrumente të tjera të KiE

Karta Sociale Evropiane (1961) është një akt ndërkombëtar i miratuar nga KiE, e cila plotëson parashikimet e KEDNJ-së, sa i takon të drejtave sociale dhe ekonomike. Kjo Kartë është rishikuar në 1996 dhe mbron të drejtat e konsideruara si gjenerata e dytë e të drejtave dhe nuk kanë gjetur vëmendje të njëjtë nga shtetet palë krahasuar me KEDNJ. Shtetet mund të ratifikojnë këtë instrument me rezerva<sup>26</sup>. E drejta për arsimim garantohet nga disa nene të Kartës, konkretisht nenet 7, 9, 10, 15, 17 dhe 19.

Shqipëria e ka ratifikuar këtë instrument ndërkombëtar me rezerva, duke mos ratifikuar pikërisht një pjesë të neneve që përfshijnë mbrojtje në lidhje me të drejtë për arsimim. Respektivisht nenet 9, 10, 15 dhe 17.

Një Konventë tjetër e KiE e cila ofron mbrojtje për të drejtën e arsimimit është dhe Konventa Kuadër e KiE për Mbrojtjen e Minoriteteve Kombëtare. Kjo Konventë garanton të drejtën e minoriteteve të aksesojnë dhe institucionet arsimore publike ose private, si dhe të edukohen në gjuhën e tyre<sup>27</sup>.

Ndërkohë, Karta Evropiane për Gjuhët Rajonale ose të Pakicave<sup>28</sup>, mbron dhe të promovon gjuhët rajonale dhe të pakicave në Evropë.

<sup>26</sup> Peçi, I. & Xhepa, I. *Cituar më lart*, f. 68.

<sup>27</sup> Nenet 12-14 të Konventës Kuadër të KiE për Mbrojtjen e Minoriteteve Kombëtare, datë 10.11.1994.

<sup>28</sup> Karta Evropiane për Gjuhët Rajonale ose të Pakicave, datë 25.6.1992.

## 2.3 Jurisprudenca e Gjykatës së Strasburgut në lidhje me të drejtën për arsimim

*Çështja trajton diskriminimin racor të personave me origjinë Rome dhe cenimin e së drejtës së tyre për arsim*

### ORSUS DHE TË TJERËT k. KROACISË

*(kërkesa nr. 15766/03)*

*16 mars 2010*

**FAKTET** Kërkuesit ishin 15 shtetas kroat me origjinë Rome të lindur ndërmjet viteve 1988 - 1994, që jetonin në Kroacinë e veriut. Në prill të vitit 2002 kërkuesit nisën një proces gjyqësor kundër shkollave të tyre fillore, me pretendimin se kurrikula mësimore kishte 30% më pak përmbajtje se kurrikulat zyrtare kombëtare. Ata pretenduan se kjo ishte një situatë e pastër e diskriminimit racor dhe cenonte të drejtën e tyre për arsim, si dhe të drejtën e tyre për t'u mbrojtur nga trajtimi çnjerëzor dhe degradues. Gjithashtu, kërkuesit paraqitën një studim psikologjik të fëmijëve romë që kishin ndjekur klasat që përbëheshin vetëm nga fëmijë Rom në rajonin e tyre. Në raport shkruhej se, fëmijët që kishin ndjekur këtë edukim të segreguar, kishin pësuar dëm emocional dhe psikologjik, si në aspektin e vetëvlerësimit, ashtu dhe në atë të zhvillimit të identitetit të tyre. Në shtator të vitit 2002, Gjykata Komunale rrëzoi padinë e kërkuesve. Ajo vërejti se arsyeja pse pjesa më e madhe e nxënësve Rom ishin vendosur në klasa të veçanta ishte për shkak se ata kishin nevojë për tutorim shtesë në gjuhën kroate. Për më tepër, kurrikula në shkollat fillore Podturen dhe Macinec ishte e njëjtë me atë të përdorur në klasat e tjera paralele të këtyre shkollave. Rrjedhimisht, kërkuesit nuk kishin arritur të vërtetonin pretendimet e tyre lidhur me diskriminimin racial. Të njëjtin qëndrim mbajti edhe Gjykata e Apelit. Ankimi kushtetues i kërkuesve paraqitur në nëntor 2003 u rrëzua mbi bazë të të njëjtave argumente, në shkurt të vitit 2007.

**VENDIMI** Bazuar në nenin 14, marrë së bashku me nenin 2 të Protokollit nr. 1, Gjykata vërejti se ky rast ngrinte kryesisht një çështje diskriminimi. Ajo risolli në vëmendje gjetjet e evidentuara në jurisprudencën e saj të mëparshme, ku është vërejtur se, si rezultat i historisë së tyre, romët janë bërë një lloj i veçantë minoriteti i pa mbështetur dhe i pambrojtur. Për rrjedhojë, atyre u duhet siguruar një mbrojtje e veçantë, duke përfshirë edhe sferën e arsimit.

Gjykata mori në shqyrtim argumentin e paraqitur nga qeveria kroate, për vendosjen e kërkuesve në klasa që përbëheshin vetëm nga rom, për shkak të problemeve në zotërimin e gjuhës kroate dhe vërejti se ky veprim nuk vinte domosdoshmërisht në kundërshtim me nenin 14 të Konventës. Megjithatë, kur kjo masë ndikon vetëm mbi anëtarë të një grupi të caktuar, autoritetet duhet të marrin masa mbrojtëse specifike. Për rrjedhojë, duke njohur përpjekjet e autoriteteve kroate për të siguruar që fëmijët rom të përfitojnë shkollim, Gjykata u shpreh se në kohën kur kanë ndodhur ngjarjet nuk ishin marrë masat e duhura për të siguruar kujdes të mjaftueshëm për nevojat e veçanta të kërkuesve, si anëtarë të një grupi të pafavorizuar. Kështu, vendosja e tyre në klasa që përbëheshin vetëm nga nxënës rom nuk ishte e justifikuar dhe binte në kundërshtim me nenin 14, të marrë së bashku me nenin 2 të Protokollit nr. 1 të Konventës. Duke u bazuar në nenin 41, gjykata i akordoi secilit kërkues nga 4,500 euro në lidhje me dëmin jomaterial dhe të gjithëve së bashku 10,000 euro në lidhje me shpenzimet gjyqësore.

★ ★ ★

*Detyrimi i shtetasve që nuk kanë hyrë ilegalisht në Bullgari për të paguar tarifë për të ndjekur gjimnazin përbën shkelje të së drejtës për arsimim*

## PONOMARYOVI K. BULLGARISË

(kërkesa nr. 5335/05)

28 nëntor 2011

**FAKTET** Kërkuesit ishin Z. Anatolij Ponomaryov dhe Z. Vitaliy Ponomaryov, me shtetësi ruse, të cilëve shteti bullgar u kishte kërkuar të paguanin një tarifë për shkollimin e nivelit të dytë (shkollë e mesme) të një institucioni arsimor publik. Sipas ligjit bullgar të arsimit, përfitojnë falas shkollimin e nivelit të parë dhe të dytë vetëm personat me shtetësi bullgare dhe disa kategori të tjera të specifikuara në këtë ligj. Të dy shtetasit (vëllezër) përfituan arsimim falas, falë lejes së përhershme të qëndrimit të nënës së tyre deri në moshën 18-vjeçare, kur duhet të aplikonin për një leje qëndrimi individuale. Kjo përkoi me vitin e fundit të shkollës së mesme dhe secilit prej tyre iu mohua e drejta për të vazhduar shkollën, për shkak se duhet të paguanin tarifën e detyrueshme për shtetasit e huaj në Bullgari. Ata bënë ankimim veçmas në Gjykata Evropiane për diskriminim si dhe për pasojat e vonesës, që solli aplikimi i lejes së qëndrimit në shkollimin e tyre. Kështu, iu kërkua Gjykatës një dëmshpërblim respektivisht 800 euro dhe 2,600 euro.

**VENDIMI** Gjykata mori në shqyrtim çështjen duke iu referuar nenit 14 të Konventës, të marrë së bashku me nenin 2 të Protokolli nr. 1, ku vërejti se praktika e ndjekur nga institucionet arsimore të Bullgarisë përbënte shkelje. Si fillim, ajo konstatoi se kërkuesit nuk ishin në pozicionin e personave që kishin hyrë në mënyrë të paligjshme në shtetin bullgar. Edhe pse ata u gjendën në një situatë ku nuk ishin të pajisur me leje qëndrimi, autoritetet bullgare nuk kishin asnjë kundërshtim thelbësor në lidhje me qëndrimin e tyre dhe nuk kishin ndonjë qëllim për t'i dëbuar ata. Gjykata vendosi se shteti bullgar, brenda afatit kohor prej tre muajsh nga data e gjykimit, në përputhje me nenin 44 § 2 të Konventës, duhet të dëmshpërblente si më poshtë vijon: për kërkuesin e parë, 2,000 euro plus taksat

respektive, për dëmtim jomaterial; për kërkuesin e dytë, 2,000 euro plus taksat respektive, për dëmin jomaterial, si dhe të dy kërkuesit bashkë 2,000 euro për shpenzimet gjyqësore.

\* \* \*

*Ruajtja e natyrës laike të institucioneve të arsimit të lartë nuk përbën shkelje e së drejtës për t'u arsimuar*

## LEYLA ŞAHİN k. TURQISË

(kërkesa nr. 44774/98)

10 nëntor 2005

**FAKTET** Në 23 shkurt 1998, Zëvendëskancelari i Universitetit të Stambollit publikoi një rregullore, e cila ndalonte studentët e mbuluar me shami të stilit islamik që të pranoheshin në lekzione, kurse apo konsultime. Gjatë kohës që ishte në fuqi kjo rregullore, Zj. Leyla Şahin, studionte pranë Fakultetit të Mjekësisë në këtë universitet. Në mars të vitit 1998, ajo u ndalua që të merrte pjesë në një provim me shkrim, për shkak se kishte të vendosur një shami të stilit islamik. Rrjedhimisht, duke përdorur të njëjtën logjikë, autoritetet e universitetit refuzuan të regjistronin Zj. Şahin në lëndë dhe provime të ndryshme me shkrim. Gjithashtu, fakulteti i dërgoi asaj një paralajmërim për thyerje të rregullores së kodit të veshjes, si dhe e përjashtoi për një semestër për shkak të pjesëmarrjes në protestën e organizuar nga studentët kundër kësaj rregulloreje. Pas rrëzimit të çështjes nga gjykatat administrative, të cilat arsyetuan se një zëvendëskancelar në universitet ka të drejtë të vendosë rregullore të tilla, edhe vendimet e Gjykatës Kushtetuese dhe Gjykatës së Lartë Administrative u shprehën se qarkorja nuk është e jashtëligjshme. Më pas Zj. Şahin vendosi të bazojë kërkesën e saj në nenin 2 të Protokollit nr. 1.

**VENDIMI** Sa i përket nenit 2 të Protokollit nr. 1, gjykata arsyetoi se, nëse shamia e stilit islamik lejohet në ciklet e para



dhe të dyta të arsimit, atëherë është e vështirë të mendohet se institucione të arsimit të lartë nuk respektojnë të njëjtën logjikë. Sidomos, në një shoqëri demokratike, ku e drejta për arsim përbën një përparim të pazëvendësueshëm për të drejtat e njeriut, neni 2 i Protokollit nr. 1 nuk mund të interpretohet me kufizime të paragrafit të parë të tij, sa i takon arsimit të lartë. Rrjedhimisht, institucionet ekzistuese të arsimit të lartë në atë kohë ishin në logjikë të drejtë të fjalisë së parë të nenit 2 të Protokollit nr. 1. Duke marrë parasysh nenin 9, gjykata arsyetoi se refuzimi i paditëses për të marrë pjesë në provime apo leksione të ndryshme, përbënte shkelje për të drejtën për arsim. Sa i përket neneve 8, 10 dhe 14, rregullorja nuk kishte për qëllim të kundërshtonte përkatësinë fetare të palës paditëse, por për të vendosur rregull dhe garantuar të drejtat dhe liritë e të tjerëve dhe synonte të ruante natyrën laike të institucioneve arsimore. Lidhur me sa më sipër, gjykata vendosi se ndër të tjera, nuk kishte asnjë shkelje të nenit 2 të Protokollit nr. 1, referuar fjalisë së parë të tij.

\* \* \*

*Çështja merr në shqyrtim abuzimin e vazhdueshëm seksual të miturve brenda institucioneve të sistemit arsimor*

## **O'KEEFFE K. IRLANDËS**

*(kërkesa nr. 35810/09)*

*28 janar 2014*

**FAKTET** Kërkuesja, Znj. Louise O'Keeffe, ishte shtetase irlandeze, e lindur në vitin 1964. Që nga viti 1968 ajo frekuentonte Shkollën Kombëtare të Dunderrow. Akuzat e para ndaj L.H., një mësuesi të shkollës lidhur me abuzimin seksual me femijë nisën në vitin 1971, por asnjëherë nuk u vërtetuan. Më pas, nga janari deri në mesin e vitit 1973, kërkuesja ishte subjekt i abuzimit seksual të vazhdueshëm nga L.H. gjatë orës së muzikës në klasën e tij. Në vitin 1974, L.H. rifilloi mësimdhënien në

një tjetër shkollë kombëtare ku vazhdoi të jepte mësim deri në daljen në pension në vitin 1975. Kërkuesja deponoi në polici në 1997 si pjesë e një hetimi lidhur me një akuzë të ngritur nga një ish-nxënës i Shkollës Kombëtare të Dunderrow kundër L.H. Kjo u pasua nga një numër i madh deponimesh të nxënësve dhe si rezultat, L.H. u akuzua për 386 vepra penale të abuzimit seksual duke u shpallur fajtor dhe dënuar me burg dhe heqje licence. Në vitin 1998, kërkuesja paraqiti një kërkesë në Gjykatën e Kompensimit të Dëmeve Penale dhe asaj iu akordua shuma prej 54,000 euro. Më pas, kërkuesja paraqiti një kërkesëpadi kundër L.H. dhe shtetit irlandez, duke pretenduar shpërblimin e drejtë lidhur me lëndimet personale të shkaktuara nga kërcënimet dhe kontakti fizik, përfshirë këtu dhe abuzimin seksual të L.H. L.H. nuk u mbrojt lidhur me pretendimet e parashtruara dhe u urdhërua të paguajë dëmin në shumën prej 305,000 euro. Megjithatë, për shkak të pamundësisë së tij ekonomike, kërkuesi në kohën e këtij vendimi siguroi me përafërsi 30,000 euro. Nga ana tjetër, kërkesat kundër shtetit u hodhën poshtë.

**VENDIMI** Kërkuesja e bazoi kërkesën e saj në nenet 3, 8, 13 dhe 14, si dhe nenin 2 të Protokollit nr. 1. Ajo pretendoi se Shteti nuk e kishte mbrojtur atë nga abuzimi seksual që i ishte bërë nga një mësues në Shkollën Kombëtare dhe se ajo nuk kishte pasur një mjet efektiv kundër shtetit në këtë drejtim. Në lidhje me aspektin thelbësor të nenit 3, Gjykata e konsideroi të nevojshme të vlerësonte çështjen e përgjegjësisë së Shtetit në kontekstin e fakteve dhe standardeve në vitin 1973. Gjykata vërejtë se autoritetet kishin një detyrim të pandarë për të mbrojtjen e të miturve nga keqtrajtimi, sidomos në arsimin fillor. Shteti duhet të kishte pasur dijeni të rreziqeve të mundshme për sigurinë e fëmijëve në atë kontekst dhe se nuk kishte kuadër të përshtatshëm në garantimin e mbrojtjes së tyre. Meqenëse mekanizmat në të cilat ishte mbështetur Shteti nuk ishin efektive, gjykata konkludoi se shteti kishte dështuar në përmbushjen e detyrimeve pozitive për mbrojtjen e kërkueses nga abuz-

imi seksual dhe për rrjedhojë, kjo përbënte shkelje të nenit 3. Për sa kohë që kërkesja nuk kishte asnjë mjet efektiv juridik në dispozicion të saj lidhur me kërkesat e pretenduara sipas nenit 3, Gjykata konstatoi se kishte pasur shkelje të nenit 13 marrë së bashku me nenin 3. Gjykata nuk e konsideroi të nevojshme marrjen në shqyrtim të kërkesave të tjera të kërkuases sipas Konventës. Gjykata i ngarkoi Irlandës për t'i paguar kërkuases shumën prej 30,000 euro për dëmin jomaterial dhe 85,000 euro për shpenzimet gjyqësore.



*Shteti duhet të garantojë gjithësi të drejtën efektive për arsim për të gjithë pa asnjë diskriminim pavarësisht se nuk ka për detyrë të ngrrejë një sistem të arsimor të ndonjë lloji të veçantë*

## **ÇËSHTJA GJUHËSORE BELGE**

(kërkesat nr. 1474/62, 1677/62, 1691/62, 1769/63, 1994/63,  
2126/64)  
23 korrik 1968

**FAKTET** Çështja e ka zanafillën në pretendimet e 324 banuesve të Alsebergut, Beerselit, të Kraainemit, Anversës, Gandit, Lëvenit dhe Vilvordës mbi pamundësinë e tyre dhe në veçanti të fëmijëve të tyre për të mësuar në gjuhën e tyre të origjinës, franceze, në rajonin ku ata banonin në shtetin Belg. Këto rrethe i përkisnin një rajoni të përcaktuar nga ligji “me gjuhë holandeze”, përveç Kraainemit. Popullsia e tyre përfshinte një pjesë të konsiderueshme frankofonësh. Kërkuessit, pra prindërit, denoncuan shkeljen e neneve 8, 9, 10 dhe 14 të Konventës si dhe të nenit 2 të Protokollit 1. Në raportin e 24 qershorit 1965, Komisioni shprehu mendimin se nëse legjislacioni belg respektonte në mënyrë të kënaqshme nenet e pretenduara nga kërkuessit, ai nuk i përgjigjej, në tre pika, kërkesave të fjalisë së parë të nenit 2 të Protokollit 1, të ndërthurur me nenin 14 të Konventës. Para së gjithash, ai pro-

vokonte heqjen e plotë të subvencioneve për shkollat rajonale, komunale ose private që zbatonin, një mësimdhënie të plotë ose të pjesshme në një gjuhë tjetër. Në vazhdim, legjislacioni belg pengonte disa fëmijë, vetëm për shkak të vendbanimit të prindërve të tyre, që të kishin mundësi të shkonin në shkollat e gjuhës franceze që ekzistonin në Lëven dhe në gjashtë bashkësitë dygjuhësore të periferisë së Brukselit. Së fundi, ky legjislacion që pas vitit 1932, përmbante refuzimin për barasvlefshmërinë e certifikatave që përcaktonin studimet tetëvjeçare që nuk ishin në përputhje me parashikimet gjuhësore.

**VENDIMI** Në interpretimin e përgjithshëm që bëri, Gjykata theksoi së pari se fjalia e parë e nenit 2 të Protokollit nr. 1 shpall të drejtën për arsim. Kjo nuk do të thotë se mes Shteteve Anëtare duhej krijuar një sistem specifik, por vetëm se ai duhet t'i garantonte personave që ndodhen nën juridiksionin e Shteteve Palë të drejtën e arsimit. Gjykata theksoi se Konventa nuk parashikon detyrime të përcaktuara dhe në veçanti, nuk përcakton gjuhën në të cilën mësimi duhet dhënë. Në lidhje me fjalinë e dytë të nenit 2 të Protokollit nr. 1, Gjykata u shpreh se dispozita e detyron Shtetin të respektojë të drejtën e prindërve për edukimin dhe arsimimin e fëmijëve të tyre, në përputhje me bindjet e veta fetare dhe filozofike, por nuk i detyron Shtetet që të respektojnë në fushën e edukimit dhe arsimimit, preferencat gjuhësore të prindërve. Gjykata arriti njëzëri në përfundimin së nuk kishte pasur shkelje në lidhje me gjashtë pikat që përfaqësonin problemet e ngritura nga kërkuesit. Në lidhje me pikën 6, refuzimin absolut të njohjes së certifikatave të shkollimit tetëvjeçar në mospërputhje me dispozitat gjuhësore në fushën e arsimit, ajo nuk e vlerësoi të pamundur që zbatimi i dispozitave të kundërshtuara të arrinte çështje specifike, në rezultate që do të rrezikonin ruajtjen e proporcionalitetit midis mjeteve dhe qëllimit, deri në masën sa të krijoheshin diskriminime. Por ajo theksoi se në çështjen në fjalë, as nuk u provua dhe as nuk u pretendua që fëmija i ndonjërit prej kërkuesve ishte cenuar nga një rezultat i tillë.



*Mos miratimi i kërkesës së prindërve për mos ndjekjen e një lënde fetare nga fëmija i tyre përbën shkelje të nenit 2 Protokollit nr. 1 i Konventës*

## **FOLGERØ DHE TË TJERË k. NORVEGJISË**

*(kërkesa nr. 15472/02)*

*29 qershor 2007*

**FAKTET** Kërkuesit janë të gjithë anëtarë të Shoqërisë Humanitare të Norvegjisë, fëmijët e të cilëve vazhdonin ciklin fillor të shkollës. Në vitin 1997, kurrikula e ciklit të parë në shkolla pësoi ndryshime duke përmbledhur dy lëndë të veçura në një të vetme. Më konkretisht, “Krishtërim dhe Filozofi” u bashkuan në “Krishtërim, fe dhe filozofi”. Kjo e fundit parashikohej që të përfshinte një mori çështjesh si: Biblën dhe Krishtërimin në këndvështrimin e trashëgimisë kulturore si dhe besimin Evangjelist Luteran (86% e popullsisë norvegjeze është e këtij besimi); besimet e tjera të krishtere; besimet fetare nëpër botë dhe filozofia e tyre; etikë dhe filozofi. Ndërkohë, gjatë kurrikulës së mëparshme, prindërit kishin mundësi të zgjidhnin që fëmijët e tyre mos ishin pjesë e leksioneve të Krishtërimit. Në bazë të ligjit të atëhershëm të Arsimit, një nxënës mund të përbënte përjashtim nga disa pjesë të lëndës vetëm në rastet kur: prindërit e konsiderojnë atë si praktikim të një feje tjetër ose të një filozofie tjetër për jetën, e ndryshme nga këndvështrimi i fesë së tyre apo filozofisë që përdorin për të jetuar. Prindërit depozituan kërkesën e tyre, bazuar në nenin 9 të Konventës dhe nenin 2 të Protokollit Nr. 1 si dhe kërkuan dëmshpërblim për shpenzimet e gjyqit si dhe për dëmin moral me një shumë totale prej 117,000 euro.

**VENDIMI** Gjykata, duke lënë mënjanë faktin se ankesat e fëmijëve sipas nenit 9 të Konventës u deklaruan të papranueshme në 26 tetor 2004, konsideroi se ankesa e prindërve bie

në fushën e veprimit të nenit 2 të protokollit nr. 1, si *lex specialis* në fushën e arsimit. Sipas qeverisë, do të ishte e mundur që prindërit kërkues të kërkonin arsimim alternativ për fëmijët e tyre në shkolla private, të cilat subvencionoheshin në masën 85% nga shteti i paditur. Sidoqoftë, Gjykata vlerësoi se, ekzistenca e një mundësie të tillë nuk mund ta përjashtojë Shtetin nga detyrimi i tij për të mbrojtur pluralizmin në shkollat Shtetërore, të cilat janë të hapura për të gjithë. Nuk duket se Shteti i paditur ka pasur kujdes të mjaftueshëm që informacioni dhe njohuritë e përfshira në kurrikulë të transmetohen në një mënyrë objektive, kritike dhe pluraliste për qëllimet e Nenit 2 të Protokollit Nr. 1. Prandaj, Gjykata konstatoi se refuzimi për t'u dhënë prindërve të kërkues përjashtim të plotë nga lënda e KRL për fëmijët e tyre shkaktoi shkelje të nenit 2 të Protokollit nr. 1. Pasi mori në shqyrtim çështjen dhe analizoi faktet, trupa gjyquese në mënyrë unanime vendosi se brenda 3 muajve shteti përkatës duhet të dëmshpërblejë paditësit me 70,000 euro për kostot e procesit.

\* \* \*

*Mos ekuivalentimi i periudhës së praktikës së kryer në një shtet tjetër nuk përbën shkelje të së drejtës për arsimim*

## KÖK k. TURQISË

*(kërkesa nr.1855/02)*

19 tetor 2006

**FAKTET** Kërkuesja, Mualla Kök është një shtetase turke, e cila ka mbaruar studimet e mjekësisë dhe një pjesë të praktikës në Bullgari. Ajo u rikthye në Turqi, ku njohu diplomën dhe vazhdoi punën si mjeke. Ndërkohë, periudha e praktikës nuk u njoh nga Ministria turke e Shëndetësisë për shkak se nuk përmbushte kriteret e kërkuara. Pas refuzimit, ajo iu drejtua Gjykatës së Lartë Administrative, e cila kërkoi detaje të mëtejshme nga Ministria e Shëndetësisë. Në 16 mars 2001 Min-

istria dërgoi një letër, për të cilën nuk ishte vënë në dijeni Znj. Kök, ku shpjegohej pozita juridike e kërkueses dhe thuhej se ajo nuk përmbushte kushtet e kërkuara për pozicionin në fjalë. Kjo bëri që gjykata të pushonte çështjen. Znj. Kök depozitoi një tjetër ankesë, lidhur me afatet e zgjatura kohore dhe padrejtësinë me të cilën ishte trajtuar çështja, duke u mbështetur tek neni 6 § 1 (e drejta për një proces të rregullt) dhe neni 2 i Protokollit nr. 1 (e drejta për t'u arsimuar).

**VENDIMI** Gjykata shqyrtoi se proceset kanë zgjatur thuajse 6 vite për të treja nivelet e gjykimit, e ndjekur nga proceset administrative preliminare. Duke marrë parasysh rrethanat e çështjes, u gjykua se vonesat ishin të tepërta dhe dështuan për të dhënë një shpërblim të drejtë brenda kohës së nevojshme. Në mënyrë unanime trupa gjykuese dakortësoi se kjo përbënte shkelje të nenit 6 § 1. Nga ana tjetër, sipas gjykatës, refuzimi i autoriteteve për të njohur periudhën e praktikës së Znj. Kök në Bullgari nuk përbën një shkelje të së drejtës për t'u arsimuar. Për pasojë, gjykata vërejti se nuk kishte asnjë shkelje të nenit 2 të Protokollit nr. 1. Megjithatë, gjykata i akordoi Znj. Kök një shumë prej 3,000 euro si shpërblim për dëmin jo-material.



*Mos pranimi i kërkuessit në universitet bazuar në supozime përbën shkelje të së drejtës së tij për t'u arsimuar*

## MÜRSEL EREN K. TURQISË

(kërkesa nr. 60856/00)

3 korrik 2006

**FAKTET** Në provimin e parë për t'u pranuar në universitet, kërkuessi rezultoi i pasuksesshëm. Tre vite më vonë, në 1997, Z. Mürsel ndjek një kurs privat për t'u përgatitur dhe kalon në provimin e parë. Pasi i nënshtrohet provimit të dytë, ai nuk

e gjen veten tek lista e fituesve, të shpallur nga universiteti. Më pas ai informohet nga Qendra e Vlerësimit të Studentëve se ishte ndër studentët me rezultatet më të larta, por i ishte hequr e drejta e pranimit për shkak të sugjerimit të një këshilli akademik, i përbërë nga 3 profesorë, i cili mori parasysh rezultatet e ulëta në provimet e mëparshme të pranimit dhe kjo, sipas tyre, përbën një arsye të vlefshme për ta bërë situatën të pashpjegueshme. Autoritetet deklaruan se kjo ishte në përputhje të plotë me rregulloren e Qendrës së Vlerësimit të Studentëve. Z. Mürsel ngriti padi, duke ndjekur të gjitha shkallët e gjykimit administrativ për të anuluar vendimin. Megjithëse gjyqtari relator i Gjykatës së Lartë Administrative e konsideroi vendimin e Qendrës së Vlerësimit të Studentëve si të bazuar vetëm mbi supozime dhe si i tillë, duhej anuluar, shumica e anëtarëve votoi për ta lënë në fuqi vendimin. Pas apeleve të shumta, asnjë gjykatë nuk mori parasysh kërkesën e paditësit, me arsyetimin se ishte e pamundur që të arrinte rezultate kaq të larta me dijet dhe aftësitë e veta.

**VENDIMI** Duke marrë parasysh dështimin e marrëveshjes mes palëve për këtë çështje, gjykata arsyetoi se kjo e fundit është subjekt i nenit 2 të Protokollit nr. 1. Gjykata arriti në përfundimin se Qendra e Vlerësimit të Studentëve, duke anuluar rezultatet e provimit të kërkuesit në bazë të këshillës së këshillit akademik, i mohoi kërkuesit të drejtën e tij për arsim. Gjithashtu, gjykata mori si shembull parimin me të cilin mori zgjidhje çështja nr. 44774/98 (*Leyla Şahin k. Turqisë*), ku thuhet se aksesit në institucionet e arsimit të lartë është një e drejtë e garantuar nga neni 2 i Protokollit nr.1, i cili në këtë rast ishte shkelur. Për këto arsye, gjykata vendosi se shteti turk duhet të dëmshpërblejë paditësin me një shumë prej 5,000 euro për dëmin moral, si dhe 5,000 euro për shpenzimet gjyqësore.



*Vendosja e nxënësve të komunitetit rom në një shkollë të caktuar përbën segregim dhe shkel të drejtën e tyre për arsimim të barabartë me të gjithë përfituesit e tjerë*

## **D.H. DHE TË TJERË K. REPUBLIKËS ÇEKE**

*(kërkesa nr. 57325/00)*

*13 nëntor 2007*

**FAKTET** Kërkuesit janë 18 shtetas çek me origjinë rome. Çështja konsiston në dërgimin e tyre në shkolla speciale, për shkak të origjinës së tyre rome. Midis viteve 1996 dhe 1999, kërkuesit, të cilën asokohe ishin minorene, janë dërguar në shkolla për fëmijë me nevoja të veçanta mendore, të cilët nuk mund të frekuentonin dot shkollat e zakonshme. Sipas legjislacionit arsimor, vendimi që një nxënës të dërgohej në një institucion arsimor të tillë, merrej nga mësuesi kujdestar, i cili bazohej në një test për matjen e koeficientit mendor në një qendër psikologjike të arsimit dhe bëhej me pëlqimin e kujdestarit ligjor të fëmijës. Në dosjen e çështjes shkruhet se prindërit, jo vetëm kanë pranuar, por në disa raste kanë kërkuar që fëmijët e tyre të dërgoheshin në një shkollë speciale. Kur ky vendim është marrë nga Qendra psikologjike e arsimit, prindërve u është dërguar një njoftim, ku u është dhënë edhe e drejta e apelimit, por asnjë prej tyre nuk bëri një gjë të tillë. Duke marrë parasysh se prindërit e tyre asokohe nuk ishin informuar në mënyrë të plotë apo të mjaftueshme, kërkuesit ngritën një padi, duke iu referuar nenit 3 dhe 14 të Konventës dhe nenit 2 të Protokollit nr. 1. Pretendimet e tyre konsistonin në diskriminimin e drejtpërdrejtë dhe në informimin e papërshtatshëm mbi pasojat që do të sillte frekuentimi i shkollave të profilit të veçantë.

**VENDIMI** Faktet e çështjes tregojnë se rregullimet e shkollimit për fëmijët romë nuk u ndoqën nga masa mbrojtëse plotësuese për të siguruar, që gjatë vlerësimit të tij në sferën e arsimit, shteti të merrte parasysh se ka nevojë për anëtarë të një klase vulnerabël. Për më tepër, si rezultat i marrëveshjeve,

kërkuesit u vendosën në shkolla për fëmijë me aftësi të kufizuara mendore, ku ndiqej një kurrikulë më bazike sesa në shkollat e zakonshme dhe ku ata ishin të izoluar nga nxënësit nga popullata e gjerë. Si rezultat, ata morën një arsimim që shtoi vështirësitë e tyre dhe kompromentoi zhvillimin e tyre të mëvonshëm personal në vend që të trajtonte problemet e tyre reale ose t'i ndihmonte ata të integroheshin në shkollat e zakonshme. Në të vërtetë, Qeveria ka pranuar në mënyrë të nënkuptuar që mundësitë e punës janë më të kufizuara për nxënësit nga shkollat speciale. Meqenëse është vërtetuar që legjislacioni përkatës, i zbatuar në praktikë në kohën materiale, kishte një efekt disproporcionalisht paragjykes mbi komunitetin rom, Gjykata konsideron se kërkuesit si anëtarë të atij komuniteti domosdoshmërisht pësuan të njëjtin trajtim diskriminues. Si pasojë, ka pasur një shkelje të nenit 14 të Konventës, të marrë në lidhje me nenin 2 të Protokollit nr. 1. Gjithashtu, gjykata vendosi se shteti çek duhet të dëmshpërblejë secilin nga 18 kërkuesit me shumën 4,000 euro për dëmin jomaterial dhe të gjithë së bashku me shumën 10,000 euro për shpenzimet e tjera gjyqësore.



## FJALORTH

**Akte nënligjore** - Vendime, rregullore, udhëzime të nxjerra nga organet ekzekutive ose organet lokale në bazë dhe për zbatim të ligjit. Këto akte kanë karakter normativ-janë të detyrueshme për të gjithë.

**Akte normative** - Kuptimi i gjerë: Akte të nxjerra nga organet ligjvënës, ekzekutive ose lokale që janë të detyrueshme për të gjithë. Kuptimi i ngushtë: Aktet normative të Këshillit të Ministrave, institucioneve të tjera qendrore ose organeve lokale - Akte të miratuara nga Këshilli i Ministrave, institucionet e tjera qendrore ose organet lokale, në rast nevojë dhe urgjence, të cilat e humbasin fuqinë që nga fillimi në rast se nuk ratifikohen nga Kuvendi brenda një afati të caktuar kohor.

**Arsim parauniversitar** - përfshin nivelet arsimore me kodet 0, 1, 2 dhe 3, sipas “Klasifikimit Ndërkombëtar Standard të Arsim-it”, të miratuar nga Konferenca e Përgjithshme e UNESCO-s, në sesionin e 29-të të saj, në nëntor 1997, përkatësisht: a) “Niveli me kodin 0”, arsimi parashkollor; b) “Niveli me kodin 1”, arsimi fillor; c) “Niveli me kodin 2”, arsimi i mesëm i ulët; ç) “Niveli me kodin 3”, arsimi i mesëm i lartë.

**Arsimi i lartë** - është arsimi terciar që çon në marrjen e një diplome akademike. Arsimi i lartë, i njohur edhe si arsimi i nivelit të tretë, është një fazë përfundimtare fakultative e arsimit formal që fillon pas përfundimit të arsimit të mesëm.

**Autoritet publik** - është çdo organ administrativ i parashikuar në legjislacionin në fuqi për procedurat administrative, organet ligjvënëse, gjyqësore dhe ato të prokurorisë së çdo niveli, organet e njësisve të qeverisjes vendore të çdo niveli, organet shtetërore dhe entet publike, të krijuara me Kushtetutë ose me ligj, shoqëritë tregtare, çdo person fizik ose juridik, të cilit i është dhënë me ligj, akt nënligjor ose çdo lloj forme tjetër, të parashikuar nga legjislacioni në fuqi, e drejta e ushtrimit të funksioneve publike.

**E drejta ndërkombëtare** - Tërësia e rregullave dhe parimeve me zbatim të përgjithshëm që rregullojnë sjelljen e shteteve dhe organizatave ndërkombëtare dhe marrëdhëniet midis tyre, si edhe disa marrëdhënie të tyre me persona fizikë ose juridikë. Zakonet ndërkombëtare dhe traktatet ndërkombëtare janë dy burimet më të rëndësishme të së drejtës ndërkombëtare.

**Ekuilibr pushtetesh** - Parimi kushtetues i organizimit të pushteteve që i jep secilës degë të pushtetit shtetëror përgjegjësi për të kontrolluar veprimet e degëve të tjera; ky parim gjithashtu kërkon që kompetencat e çdo dege të jenë relativisht të ekuilibruara për të parandaluar mbizotërimin e një degë të pushtetit mbi të tjerat.

**Kurrikul** - është tërësia e dokumentacionit si: korniza kurrikulare, plani shkollor, programi mësimor, teksti dhe materiale të tjera të një lënde ose fushe të të nxënit dhe e tërë veprimtaria e organizuar në mjedisin e tëmësuarit, që shërben për të siguruar një formim të caktuar të atyre që nxënë.

**Kushtetutë** - Ligji themeltar i shtetit që shpreh parimet themelore të sistemit juridik. Dokumenti që përcakton normat themelore të organizimit të shtetit, strukturën dhe funksionet e organeve kryesore të qeverisjes së shtetit, parimet bazë të procesit politik dhe marrëdhëniet bazë të shtetasve me shtetin.

**Minoritet** - pakicë kombëtare që jeton në një vend a në një shtet tjetër që gëzojnë të drejta.

Nënës me aftësi të kufizuar- është personi, i cili ka dëmtime afatgjata fizike, mendore, shqisore, të sjelljes ose të kombinuara, që, në ndërveprim, mund ta pengojnë të marrë pjesë në mënyrë të plotë dhe të barabartë në arsimimin e tij dhe në jetën shoqërore.

**Nxënës** - është personi që arsimohet në arsimin parauniversitar.

**OKB** - Organizata e Kombeve të Bashkuara është organizata më e madhe në botë e cila ka për qëllim sigurinë ndërkombëtare, zhvillimin ekonomik dhe barazinë sociale. Ajo u formua në vitin 1945 me iniciativën e shteteve fituese të Luftës së Dytë Botërore (ShBA, Kina, Anglia, Bashkimi Sovjetik dhe Franca) dhe zëvendësoi Lidhjen e Kombeve e cila ishte formuar në vitin 1919 por nuk ishte tregua efektive për mënjanimin e Luftës së Dytë Botërore.

**PISA** - Programi për Vlerësimin Ndërkombëtar të Nxënësve (Programme for International Student Assessment - PISA) është një hulumtim ndërkombëtar në nivel botëror i cili bëhet nga ana e Organizatës për Zhvillim dhe Bashkëpunim Ekonomik (OECD) në vendet anëtare dhe jo-anëtare të kombeve për nxënësit 15 vjeçar e ku vlerësohen performancat e nxënësve në matematikë, shkencë, dhe lexim. Për herë të parë ky hulumtim është kryer në vitin 2000 dhe pastaj është përsëritur çdo tre vjet. Kjo është bërë me qëllim të përmirësimit të politikave arsimore.

**Shtet demokratik** - Konsiderohen demokratike ato shtete që garantojnë zgjedhje të përgjithshme periodike, të lira dhe të fshehta, pluralizëm politik dhe pluralitet të mjeteve të informacionit.

**Shtet i së drejtës** - Karakteristikat dalluese të shtetit të së drejtës janë: **1.** Supremacia e ligjit si shprehje e sovranitetit popullor nëpërmjet parimit të përfaqësimit. **2.** Një sistem hierarkik normash juridike, në krye të të cilit qëndron Kushtetuta. **3.** Ndarja e pushteteve publike, secili me një sferë të caktuar kompetencash, si garanci e demokracisë. **4.** Sistem garantues i lirive të parashikuara në Kushtetutë. **5.** Parimi i ligjshmërisë (përputhja me kushtetutën dhe ligjet) së veprimeve të administratës dhe një sistem ankimimi kundër veprimeve administrative të paligjshme. Gjithashtu, shteti i së drejtës kërkon edhe garanci në drejtim të abuzimeve të mundshme të legjislativit me anë të kontrollit të kushtetutshmërisë së ligjeve.

**UNESCO** - Organizata për Edukim, Shkencë dhe Kulturë e Kombeve të Bashkuara) është një agjensi e specializuar e Kombeve të Bashkuara e themeluar më 16 nëntor 1945. Qëllimi i deklaruar i kësaj organizate është të kontribuojë për paqen dhe sigurinë në Botë duke nxitur bashkëpunimin ndërkombëtar përmes arsimit, shkencës, dhe kulturës.



## BIBLIOGRAFIA

### Akte normative ndërkombëtare

- » Deklarata Universale e të Drejtave të Njeriut, 1948
- » Konventa Evropiane për të Drejtat e Njeriut, 1950
- » Konventa Kundër Diskriminimit në Arsim, 1960
- » Pakti Ndërkombëtar mbi të Drejtat Civile dhe Politike, 1966
- » Pakti Ndërkombëtar për të Drejtat Ekonomike, Sociale dhe Kulturore, 1969
- » Konventa Ndërkombëtare për Eliminimin e të Gjitha Formave të Diskriminimit Racor, 1979
- » Konventa mbi Eliminimin e të Gjitha Formave të Diskriminimit Ndaj Grave, 1979
- » Konventa për të Drejtat e Fëmijës, 1989
- » Karta Evropiane për Gjuhët Rajonale ose të Pakicave, 1992
- » Konventa Kuadër e Këshillit të Evropës për Mbrojtjen e Minoriteteve Kombëtare, 1994
- » Konventa për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara, 2006
- » Karta e Lirive dhe të Drejtave Themelore të Bashkimit Evropian (2000/C 364/01)

### Ligje dhe akte nënligjore në fuqi

- » Ligji nr. 8417 datë 21.10.1998 "Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë", e ndryshuar.

- » Ligji nr. 69 datë 21.6.2012 “Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar.
- » Ligji nr.80/2015 datë 22.07.2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”.
- » Ligji nr. 15/2017 “Mbi arsimin dhe formimin profesional në Republikën e Shqipërisë”, datë 16.2.2017.
- » Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 818 datë 26.11.2014
- » Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 396 datë 22.8.1994 “Për arsimin 8 vjeçar në gjuhën amtare të pakicave”.
- » Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 554 datë 31.7.2019 “Mbi krijimin, organizimin dhe funksionimin e Agjencisë për Punësim dhe Aftësi”.

### Dokumente politike

- » Strategjia e Arsimit Parauniversitar 2012-2020, Fletore Zyrtare nr. 2/2016, f. 18.
- » Strategjia Kombëtare për Punësim dhe Aftësi 2014-2020
- » Strategjia Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim (2014-2020)
- » European Commission. Progress Report made by Albania during 2002
- » European Commission. Progress Report Albania 2003
- » European Commission. Progress Report Albania 2006
- » European Commission. Progress Report Albania 2007
- » European Commission. Progress Report Albania 2008
- » European Commission. Progress Report Albania 2010
- » European Commission. Progress Report Albania 2011
- » European Commission. Albanian Progress Report 2020

### Legjislacion i shfuqizuar

- » Ligjë nr. 281 datë 17.8.1946 mbi arësimin fillor të detyruar.- Gazeta Zyrtare Nr.85, E Martë 10 shtator 1946
- » Dekreti i Presidiumit të Kuvendit Popullor, nr. 1484, datë 12 qershor 1952, “Mbi arsimin shtatëvjeçar të detyruar”, Gazeta Zyrtare nr. 11, viti 1952.
- » Vendim nr. 341, datë 03.11.1953. Mbi reduktimin e programeve të shkollave të natës.- Gazeta Zyrtare Nr.17, 14 Nëntor 1953, f.401



- » Ligji nr. 4624, datë 24.12.1969 “Mbi sistemin e ri arsimor”.
- » Ligji nr. 7635 datë 11.11.1992 “Për disa ndryshime në ligjin nr. 4624 datë 24.12.1969 “Për sistemin e ri arsimor”.
- » Ligji nr. 7952 datë 21.6.1995 “Për sistemin arsimor parauniversitar”.
- » Ligji nr. 7810 datë 29.04.1994 “Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë”.
- » Ligji nr. 8461 datë 25.02.1999 “Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë”.
- » Ligji nr. 9741 datë 21.05.2007 “Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë”.

### **Tekste dhe artikuj**

- » Akademia e Shkencave e Shqipërisë. (2008). *Fjalor enciklopedik shqiptar: Vëllimi I*. Tiranë.
- » Anastasi, Aurela. (2007). Historia e të drejtës kushtetuese në Shqipëri (1912-1939). Tiranë: botimet Pegi.
- » Bianku, Ledi. & Mole, Nuala. & Smith, H. (2020). *Covid-19 dhe impakti mbi të drejtat e njeriut: shikim i përgjithshëm mbi jurisprudencën përkatëse të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut*. Tiranë: AIRE Centre.
- » Duro, Çlirim. (2012). *Arsimi i Lartë në Shqipëri: 1946-1968 (punim doktore)* <http://www.doktoratura.unitir.edu.al/wp-content/uploads/2013/08/Doktoratura-Clirim->
- » Duro-Fakulteti-i-Histori-Filologjise-Departamenti-i-Historise1.pdf.
- » European Court of Human Rights. (2020). *Guide on Article 2 of Protocol no. 1 to the European Convention on Human Rights*. Strasbourg: ECHR.
- » Jager, M. (...). *Meandering through Policy Development: Observations on Vocational Education and Training in Albania*.
- » Karameta, P. et.al (2014). *Reforma në sistemin arsimor parauniversitar: raport paraprak*.
- » Koliqi, Hajrullah. (2002). *Historia e arsimit dhe e mendimit pedagogjik shqiptar*. Prishtinë: Universiteti i Prishtinës & Libri Shkollor.
- » Miço, Heliona. (2019). *Një vështrim i përgjithshëm mbi të drejtën për arsim në Shqipëri ecuria e kësaj të drejte në përputhje me standardet ndërkombëtare dhe legjislacionin*

evropian (punim doktrate) <https://unitir.edu.al/wp-content/plugins/pdfjs-viewer-shortcode/pdfjs/web/viewer.php?file=https%3A%2F%2Funitir.edu.al%2Fwp-content%2Fuploads%2F2020%2F05%2FDoktorata-Heliona-Mi%2C3%A7o.pdf&download=true&print=true&openfile=false>

- » Miço, Heliona. & Zaçellari, Manjola. (2019). *Polish Journal of Educational Studies*: “Legal aspects of participation practices in the Albanian education Context”.
- » Miço, Heliona. (2012). *Zhvillimi i legjisllacionit arsimor shqiptar në shoqërinë demokratike*,
- » Mole, Nuala. & Liaki, Vasi. (2018). *Drejt një zbatimi efektiv në nivel kombëtar të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut: një guidë mbi parimet konceptet kyçe të Konventës dhe përdorimi i tyre nga gjykatat vendase*. Beograd: AIRE Centre.
- » National Employment and skills Strategy 2014-2020. *Annual Progress Report 2017: Indicators for monitoring of key targets of NESS 2014-2020 (%)*.
- » Nowak, M. (2003). *Introduction to the international human rights regime*. Leiden: Brill academic publishers.
- » Omari, Luan. & Anastasi, Aurela. (2017). *E drejta Kushtetuese*. Tiranë: Dajti 2000.
- » Peçi, Ildir. & Xhepa, Ina. (2019). *E drejta për mbrojtjen nga diskriminimi: manual*. Tiranë: Qendra Europiane & Konrad Adenauer Stiftung.
- » Petrela, Iris. & Kodra, Klara. (2017). *E drejta për informim dhe liria e shprehjes: manual*. Tiranë: Qendra Europiane & Konrad Adenauer Stiftung.
- » Shema, Isak. (2019). *Periodizimi i zhvillimit të arsimit shqiptar gjatë shekujve* <http://www.fokusi.org/periodizimi-i-zhvillimit-te-arsimit-shqiptar-gjate-shekujve/>

### Burime nga interneti

- » <https://konica.al/2018/10/retrospektive-shkollat-profesionale-ne-kohen-e-komunizmit/> [konsultuar më 01.10.2020].
- » <http://www.instat.gov.al/media/4621/statistika-t%C3%AB-regjistrimeve-n%C3%AB-arsim-2017-2018.pdf> [konsultuar më 04.10.2020]

- » [https://www.oneplanetnetwork.org/sites/default/files/albania\\_national\\_strategy\\_on\\_development\\_and\\_integration.pdf](https://www.oneplanetnetwork.org/sites/default/files/albania_national_strategy_on_development_and_integration.pdf) , Strategjia Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim (2014-2020) [konsultuar më 05.10.2020]
- » <http://www.instat.gov.al/al/temat/tregu-i-pun%C3%ABs-dhe-arsimi/arsimi/#tab2>, tabela 1 exel, [konsultuar më 05.10.2020]
- » <https://data.consilium.europa.eu/doc/document/ST-8543-2019-INIT/en/pdf>, Albania Economic Reform Programme (ERP) - 2018-2020 Assesment
- » [https://ec.europa.eu/neighbourhood-enlargement/sites/near/files/pdf/key\\_documents/2014/20140919-csp-albania.pdf](https://ec.europa.eu/neighbourhood-enlargement/sites/near/files/pdf/key_documents/2014/20140919-csp-albania.pdf) [konsultuar më 5.10.2020].
- » [http://portal.unesco.org/en/ev.php-URL\\_IDç27968&URL\\_DOç-DO\\_TOPIC&URL\\_SECTIONç201.html](http://portal.unesco.org/en/ev.php-URL_IDç27968&URL_DOç-DO_TOPIC&URL_SECTIONç201.html) [konsultuar më 12.10.2020].
- » <https://www.coe.int/en/web/portal/47-members-states> [konsultuar më 13.10.2020].
- » [http://bunkart.al/1/ekspozita\\_muzeale/arsimimi-ne-shqiperi-1945-1990](http://bunkart.al/1/ekspozita_muzeale/arsimimi-ne-shqiperi-1945-1990) [konsultuar më 05.09.2020].

